

*Master Profesional në Politika dhe Administrim / Drejtim Turizmi*



Temëdiplome : “E ardhmja e turizmit në qytetin e Pogradecit”

Punoi Arjola Pillati

Petagogu udhëheqës I temes:

Msc.Hysni Ahmeti

Data 15.1. 2013 Durrës

Mirnjohje


Universiteti Aleksander Moisiu është një universitet I cili ndodhet ne hapat e par ate verpimtarise se tij. Por pavaresisht ketij fakti te te jane te punesuar nje nga stafet petagogjike me te kualifikuar të cilët me përkushtimin e tyre me kane beret e mundur qe une te kem njohuri te thella ne fushen e turizmit.Dega te cilen une kam studjuar eshte mjaft komplekse ne vetvete sepse ajo ne vetvete permban nje sere degesh te tjera.

Ky universitet eshte ndryshe nga te tjeret persa I perket konceptimit dhe funksjonimit.Ne te jane te nderthurura metodat me te mira jo vetem te mesimdhenjes.

Dega qe une kam studjuar Drejtim Turizmi më ka ndihuar qe konceptimi im kete dege te jete me I thelluar .

U jam mirnjohese te gjithë stafit petagogjik I cili me nje perkushtim te theksuar me kane pere qe un ta studjoj me pasjon kete dege.

Falenderoj gjithashtu te gjithë stafin drejtues te ketij universiteti sepse fale kordinimit te punes se bere nga ta un sot kam nje te ardhme te sigurt ne karjere.



# Struktura

Kapitulli I : Hyrje.

Kapitulli II: Përshkrimi historik.

2.1 Pozita gjeografike dhe klima.

2.2 Ndarja administrative dhe popullsia.

2.3 Pasuria etnografike.

2.4 Kultura dhe arsimi.

2.5 Zhvillimi i ekonomisë dhe degët e saj ndër vite.

Kapitulli III: Zhvillimi i turizmit dhe rëndësia e tij në qytetin e Pogradecit.

3.1 Historiku i zhvillimit të turizmit.

3.2 Degët e turizmit të cilat mund të zhvillohen në këtë zone.

3.3 Strategjia e zhvillimit.

3.4 Analiza Swot.

3.5 Gjëndja aktuale e zhvillimit të turizmit dhe ndikimi i tij tek banorët.

Kapitulli VITë dhëna të mara nga pyetsori .

4.1 Pyetsori drejtua subjekteve turistike.

4.2 Pyetsori drejtuar turistëve.

4.3 Pyetsori drejtuar studentëve të profilit turizëm.

Konkluzjone

Rekomandime

Biblografia

## Abstrakt

Turizmi sot wshtw shumw i rwndwsishwm e sidomos pwr ekonominw e vwndit tonw. Zhvillimi i turizmit nw vwndin tonw bwhtet i mundur sepse ne zoterojme njw swrw burimesh turistike. Njw nga destinacionet e vwndit tone qw po twrheq njw numur tw madh turistwsh wshtw Pogradeci. Zgjodha tw trajtoj kwtw temw pasi kwtw qytet e njoh mw mirw se tw tjerwt. Kjo temw wshtw e bazuar kryesisht mw tre pyetsorw drejtuar tre elementwve bazw , sic janw turistwt studentwt qw studjonw nw kwtw profil , si dhe subjektet turistike.


Nw kwtw temw trajtohet pikwrish zhvillimi i turizmit si degw e ekonomisw nw kwtw qytet. Gjithashtu nw tw trajtohen jo vetwm burimet turistike por edhe problematikat e shumta me te cilat pwrballen turistwt dhe jo vetwm.

Fokusimi I kwsaj teme wshtw tek mwnyra si si mundet qw ky turizwm tw jetw I zhvilluar dhe nw tw ardhmen. Nw kwtw studim kwto faktorw janw studjuar jo vetwm nw nivele vendore por edhe qwndrore .

Nw fund tw kwsaj teme janw dhenw njw swrw rekomandimesh ,tw cilat do tw ndihmonin nw zhvillimin e turizmit nw kwtw qytet.

Rekomandimi primar wshtw qw ushtrimi i veprimtarive turistike tw jetw i shtrirw gjatw gjithw vitit duke nisur me promovimin mw tw madh si dhe uljen e cmimeve jashtw sezonit.

Kjo temw nxjer disa pwrfundime tw rwndwsishme tw cilat do tw ndihmojnw nw zhvillimin e turizmit nw tw ardhmen .



## The abstract


The tourism in now days is very important especially for the economy of our country. The tourism in our can country can be easily develop because our country has got a lot of touristic resorcues. One of the destinations that is attracting a lot of turists recently is Pogradeci. I choose this topic because I know this city very well. This topic is organize mainly to three questenariious. This questenariious involve three basic elements: the tourists, the students that study in tourism and the touristic subjects.

In this topic I speak about the tourism in this city as the main possibility for developing the city. In this topic I treat not only the tourstic resorcues but also the problems that the toursits faces. This topic foccus in the ways that how the tourism can be develop in the future.

In the end of this topic I give some recomandations that show how can the tourism be develop in this city.

The first recomandation is about having tourism all the season and not only in summer and this is possible only if the turstic subjects practice low prices.

In conclusion this topic tells us how the tourism can be develop in the future.



## Kapitulli 1 : Hyrje

Pogradeci është një qytet i cili ndodhet buzë liqenit të Ohrit. Madhështor është ky qytet jo vetëm në dimër por edhe në stinët e tjera të vitit, sepse secila ka një bukuri të pa krahasueshme me tjetrën. E reja dhe e vjetra, modernja dhe tradicjonalja bashkohen pa cënuar njëra tjetrën. Liqeni, mali fushat gjithcka në Pogradec është në harmoni të plotë. Kjo harmoi e ka bërë të vizitueshëm këtë qytet jo vetëm në stinën e verës por edhe në dimër. Liqeni i Ohrit ka luajtur gjithnjë një rol kyç në zhvillimin e këtij qyteti që në kohët e lashta. Zona e liqenit të Ohrit ka vlera të mëdha jo vetëm ëkonomike por edhe arkeologjike, në të përfshihen zona të tilla si: Varret e Selcës, që datojnë në shek IV para erës së re, mozaikët dhe bazilikat kristjane të shek VII që gjenden në fshatin Lin.

Një specje e rrallë që gjendet vetëm në këtë qytet është korani i cili gatuet me mjeshtëri vetëm nga pogradecarët, por ajo që e shoqëroj gjithmoj është vera e cila është kthyer tashmë në një traditë e cila trashëgohet me fanatizëm nga brezi në brez, në nder të saj është shpallur edhe dita e vererave më 21 dhe 22 dhjetor të çdo viti.

Por Pogradeci mbart edhe një trashigimi të pasur kulturore. Kjo traditë kulturore rruhet dhe pasurohet vit pas vit. Pogradeci është një qytet i adhuruar nga poetët dhe piktorët. Ai ka një numur të konsiderueshëm shkrimtarësh ku dy më të spikaturit sigurisht që janë Llazar Gusho (Lazgush Poradeci) dhe Mitrush Kuteli.

Në muaji korrik dhe gusht popullsia e këtij qyteti dyfishohet jo vetëm nga turistët vendas por edhe ata të huaj. Gjithkush që ka ardhur në Pogradec do të rikthehet sërish tek ai sepse patjerë që ka për të zbulur një botë tjetër.

Por Pogradeci nuk do të kishte kuptim pa parkun e Drilonit i cili ndodhet vetëm 4 km larg qytetit në skajin jugor të tij. Ky park është me një bukuri dhe qetësi prrallore. Disa metra larg Drilonit do të gjeni një nga fshatrat turistik më të frekuentuara të kësaj krahine dhe ai është Tushemisht. Atë e bën njëvend të preferuar turistik liqeni dhe ajri i freskët e i pastër, mjediset e gjelbëruara natyrore, burimet e shumta natyrore ujore, bregu i gjerë dhe i pasur me rërë për plazh me gjatësi mbi 3km.

Në këtë zonë është më së shumti i preferuar turizmi familjar, ku përvec hoteleve do të gjeni edhe shtëpi me qera të lëshuar nga banorët e tij me një cmim të arsyeshëm. Këtu vend sot përbën një ofertë fantastike për turistët pasi ka në përbërjen e tij një shumëllojshmëri alternativash, duke filuar

që nga turizmi blu, ai kulturor, turizmi dimëror, ai i festive të ndryshme dhe panairove, turizmi artisanal etj.

## Kapitulli II :Përshkrimi historik

### •Parahistoria dhe perjudha ilire

Zbulimet e bëra nga gërmimet arkeologjike tregojnë se treva e Pogradecit ka qënë e banuar që në kohët e lashta. Kjo trevë përmendet historikisht për pozitën e favorshme gjeografike, për pasuritë dhe bukuritë e saj. Por pikërisht për këto favore që ajo ka është bërë shpesh herë harenë luftrash politike dhe ekonomike. Mendohet se popullsia e kësaj krahine I ka fillimet që në perjudhën e neolitit të hershëm (6000 p.e.r), kjo dëshmohet me vendbanimet palafite (shtëpi druri të ndërtuara në liqen mbi hunj). Numri më i madh i vendbanimeve u shtua më shumë në perjudhën e bakrit bronzit e ca më shumë në atë të hekurit (në këtë perjudhë u përsosën edhe më shumë veglat e punës). Por dëshmitë më të lashta dhe të pa kundështueshme janë gjetjet arkeologjike. Pranë kishës së vjetër të qytetit, asaj të Shën Prokopit janë gjetur tuma (gurë varresh) të epokës së hekurit me mbishkrime të emrave ilir si: Kliti, Dasion, Genti etj. Liqeni i Ohrit në atë kohë quhej Lyhnidas (që në latinisht do të thotë liqeni i dritës) dhe përgjatë tij banonte fisi ilir i enkelenasve. Karakteristikë e këtyre fiseve ishte ndërtimi i vendbanimeve të tyre në një larësi të konsiderueshme (në mënyrë që ta kishin në kontroll të gjithë teritorin nga ndonjë sulm i muncëm) të lilla janë kalaja e qytetit, kalaja në Blacë dhe Selcën e Poshtme. Sipas historianëve të lashtë, në këto treva fisi i enkeleasve krijua një qytet të rëndësishëm jo vetëm ekonomikisht duke zhvilluar tregëtinë por dhe kulturor. Vendbanimi i tyre mori emrin Enkelana (e lidhur kjo me fisin ilir që banonte në të). Në shek V–III p.e.r fuqia dhe lulëzimi i enkelenasve me në krye mbretin e tyre Bardhyl arriti kulmin dhe u vu në krye të shtetit ilir. Një prej shkrimtarëve më të mëdhenj të kësaj krahine Mitrush Kuteli në romanin e tij historik *“Një copë të Ilirisë së Poshtme”* përshkruan enkelejasit si një fis me organizim të fortë shtetëror dhe ushtarak, me qytetërim dhe kulturë të zhvilluar, me dashuri të madhe për vendlindjen.

### •Perjudha e pushtimit Romak

Iliria pas përpjekjeve të shumta të shoqëruar me luftra të ashpra e të gjat në shek IV–II, ranë nën pushtimin e Perandorisë Romake. Por jeta në Enkelanë pavarësisht pushtimit e ruajti zhvillimin e saj falë rrugës ndërkombëtare Egnatja që lidhte Dyrrahun me Kostandinopojën, ku degëzime të

kësaj rruge përshkonin qytetin dhe Mokrën ( sot fshat në rrethin e Pogradecit).Gjatë kësaj perjudhe në Enkelanë u përhap feja e krishterë.Më 395 Perandoria Romake u nda nëdy pjesë në atë Romake dhe Bizantine.Illiria u përfshi në lindje dhe u drejtua nga Perandoria Bizantine.Nga qytetërimi I kësaj perjudhe vijnë dëshmi të pa kundështueshme sic është mozaiku i Linit I cili pasqyron botën e pasur bimore dhe shtatëzore të kësaj zone. •Pushtimi sllavValë të tjerash sulmesh erdhën në shek V–VI nga gotët ( fise të vjetra gjermane) hunët etj të cilët dogjën dhe plackitën qytetin.Në shek VI filloi pushtimi i rëndë e I gjtë sllav I cili sllavizoi emrat e vëndeve kudo që ai sundonte.Pikërisht në këtë përjudhë u ndryshua emir nga Enkelanë në Pogradec ( Pogradec fjalë slave që do të thotë nën kala)emër që mban edhe sot.U sllavizuan gjithashtu edhe emrat e fshatërve të kësaj zone si prsh: Starovë,Zagorcan, Selcë etj.

#### •Perjudha e Mesjetës

Në fillim të Mesjetës ilirët u quajtën arbër kurse vëndi Arbëri.Perandoria Sërbe ra në vitin 1355,kjo bëri që Arbëria të ndahej në principata me në krye princat.Kjo mënyrë qeverisje vazhdoi deri në shek XV, dhe më pas erdhi njëjtjetër pushtim i gjatë dhe i rëndë , ai turk i cili do të mbizotërontë për pesqint vjet radhazi.

#### •Pushtimi Osman.

Turqia vendosi në vëndin tonë një rregjim të egër ushtarak, me taksa të larta e të pa përballueshme për masën më të madhe të popullsisë.Kundër këtij pushtimi shpërthyen kryengritje, të vazdueshme të udhëhequr nga princat shqipëtar.Një kontribut të rëndësishëm në këtë lufte kanëdhënë Mokra dhe zona përeth saj.Beteja e zhvilluar në Mokër kunra turqëve është fituar prej tyre madje edhe sot ka vënde në Selcën e Poshme që quhen "varret e turqve".Pushteti Osman përhap gjithashtu edhe fene islame të cilën e pushtuan një numur i konsiderueshëm njerzish të cilët nuk mundnit të paguanin dot taksat e lara.Në këtë perjudhë u krijuan pashalleqet.Pas rënjes së pashallëqeve Turqia e ndau vëndin në 4 vilajete.Secili vilajet ndahej në sanxhakë,dhe secili sanxhak ndahej në kaza.Pogradeci bënte pjesë në vilajetin e Manastirit, në sanxhakun e Ohrit dhe në kazanë e Starovës.Kjo ndarje administrative vazhdoi për 80 vjet rradhazi deri në vitin 1912.

#### •Perjudha e Rilindjes Kombëtare.



Gjatë kësaj perjudhe rrethi I Pogradecit ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në përhapjen e gjuhës shqipe dhe jo vetëm. Shkolla shqipe u hap një javë më vonë se ajo e Korçës. Me të drejtë në Fjalorin Enciklopedik Shqipëtar thuhet: "Gjatë Rilindjes Kombëtare Pogradeci u bë qendra e veprimtarisë atdhetare dhe baza e cetave të lirisë". Dhe pas shpalljes së pavarësisë Pogradeci mbeti sërisht një shesh luftrash duke filluar me Luftën Ballkanike e më pas me Luftën e I Botërore.

•Perjudha e mbretërisë (1925 – 1939).

Në këtë perjudhëvëndi mori mjaft zhvillime të reja. Më 1928 u ndërtua në Kabash një hidrocentral dhe Pogradeci u bë ndër të parat qytete të Shqipërisë që u ndricua me dritë elektrike. Po kështu është ndër të parat qytete që hapi kinema krijoi teatër dhe bibliotekë. Kjo perjudhë ka qënë një ndër më të mirat e këtij qyteti. •Lufta italo – greke (1940–1941). Lufta italo–greke frontin e saj të fundit e ndali pikërisht në Pogradec. Midis italkanëve dhe grekëve filloi një luftë e ashpër. Artileria italjane ishte e vendosur në Kalan e qytetit ndërsa artileria greke u vendos në Tushemisht. Vazhdimisht të dy kundështarët sulmonin njëri tjetrin me predha nga vëndet strategjike të cilët ata kishin zënë, por shpesh herë ato predha binin brënda në qytet duke shkaktuar një numur të madh të vrarësh si dhe shumë shtëpi të shkatëruara. Më pas erdhë gjermanët me ndihmën e italkanëve dhe grekët u tërhoqën në vëndin e tyre. Në këtë perjudhë filluan të krijoheshin cetat e para clirimtare. Pas shumë përpjekjesh më 30 gusht 1944 Pogradeci u clirua plotësisht. Vitet 1943–1944 si rrall herë Pogradeci u dogj tre herë në një hark kohor prej një viti. Pas clirimit vëndi ynë hyrin në regjimin komunist, dhe pas viteve 90 në zhvillimin e sistemit demokratik. Emblema e qyteti të Pogradecit. Motivi I kësaj emblem është marë nga një paftë brezi e zbuluar nga gërmimet arkeologjike në Selcën e Poshtme, e cila shpalos një skenë mitologjike luftimi me katër luftëtar ku përpara kanë armiqtë pas kanë një dragua I cili simbolizon perëndin mbrojtëse. Kjo paftë i përket shek III para Krishtit. Por kjo emblem përfaqëson nga ana tjetër edhe një gjarpër uji nisua kjo nga forma e bishtit, dhe kjo trego se sa I rëndësishëm ka qënë liqeni për këtë popull.



(Fig.nr1 Simboli I Bashkis Pogradec) (Fig.nr 2 Paftë brezi e gjetur në shek III para Krishtit në Selcën e Poshtme)

## 2.1 Pozita gjeografike dhe klima

Rrethi I Pogradecit është spikatur gjithmonë për një pozitë gjeografike mjaft të favorshme për të zhvilluar blektorine dhe buqësinë, të cilat janë degë shumë të rëndësishme në këtë krahinë e sidomos në zonat rurale. Ky rreth bën pjesë në rajonin juglindor të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me rrethin e Librazdit, në jug me rrethin e Korçës, në perëndim me rrethin e Gramshit dhe në lindje me kufirin e shtetit maqedonas përmes liqenit të Ohrit. Sipërfaqja e rrethit është 725km<sup>2</sup>. Pogradecin e përshkojnë pragje dhe male të larta, që janë vazhdim i maleve të Mokrës, fusha të rafshta lugina e gryka. Rajoni I Pogradecit ka një perimetër kufiri prej 137 kilometra, nga këto kufiri tokësor është 113 kilometra dhe ujqor e liqenor 23.5 kilometra. Por pjesa më e rëndësishme e reljevit është liqeni i Ohrit me moshë rreth 3 milion vjet. Për vlerat historike, florën dhe faunën unike në vitin 1980 është shpallur nga UNESCO si vënd i trashigimisë botërore. Ai konsiderohet si një prej 4 liqeneve më të vjetër në botë. Vija bregliqenore shqipëtare zgjatet nga fshati Tushemisht deri në atë të Linit, me një gjatësi prej 88 kilometrash. Ky liqen ka jo vetëm një rëndësi mjedisore por edhe ekonomike. Një ndër specjet e rralla që rritet në këtë liqen dhe që tërheq mjaft turistë është korani. Klima e Pogradecit është mesatare paramalore dhe mallore. Temperatura mesatare vjetore është 11°C, mesatarja në dimër është 2.2°C, kurse mesatarja në verë 22°C. Gjatë vitit numurohen 300 ditë me djell. Sasia vjetore e rreshjeve është 765 mm.

## 2.2 Ndarja administrative dhe popullsia

Për fat të keq mungojnë dokumenta të cilat tregojnë ndarjen administrative të këtij rajoni. I vetmi dokument vjetërshtë ai i Evlia Celebisë i shek VII, i cili jep një përshkrim të dy qendrave të asaj kohe, Starovës dhe Pogradecit. Ndarja administrative e parë ka qënë në formen e vilajeteve këto të ndara në sanxhaqe dhe më pas në kazase. Pogradeci bënte pjesë në vilajetin e Manastirit, në sanxhakun e Ohrit dhe në kazanë e Starovës. Në vitin 1881 Pogradeci kaloi në sanxhakun e Korcës. Në vitin 1919 qarku i Pogradecit kishte 4 krahina: 1. Krahina e Pogradecit 2. Krahina e Lenijes 3. Krahina e Pirgut 4. Krahina e Quksit. Me krijimin e shtetit tërëdithe të pavarur, ndryshoi edhe struktura administrative e shtetit. Kështu Pogradeci u kthye në nënënprefekturë e cila kishte nën administrim:

1. Rrethi i Qendrës. 51 katunde, 2883 shtëpi, 19216 banorë. 2. Krahina e Gorës me 26 katunde, 855 shtëpi, 4860 banorë. Më pas Pogradeci u nda në 5 katundari. Nën prefektura ishte organi më i lartë, me në krye nënprefektin dhe këshillin që përbëhej nga 12 antarë. Bashkia kishte në juridiksion qytetin e kryesohej nga kryetari dhe këshilli bashkiak, që merrej me mbledhjen e taksave, pastrimin dhe rregullimin e rrugëve. U formuan komunat të cilat kishin përfaqësuesit e tyre. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe çlirimin e vëndit ndryshoi sërisht struktura administrative e vëndit, në cdo komunë u ngritën këshilla nacionalçlirimtar. Komunat u quajtën lokalitete, pastaj rrethe dhe qarqe. Më 1970 Pogradeci u bë me pesë lokalitete ose në total 17 fshatra. Kurse mbas vitin 1991 u krijuan 7 komuna. Qendra administrative e rrethit ka qënë qyteti i Pogradecit. Popullsia e këtij qyteti ka ndryshuar ndër vite, me emigrime dhe migrime të brëncme dhe të jashtme. Lëvizja më e madhe nga zonat rurale drejt qytetit është shënuar pas viteve 90. Të dhënat për regjistrimin e popullsisë në këtë zonë datojnë që në vitin 1923 dhe deri në ditët e sotme. Tabela nr. 2.2.1 Ndryshimi i numrit të popullsisë ndër vite.

Viti I regjistrimit	Popullsia e përgjithshme	Banorë në qytet	Banorë ne fshat
1923	17254	2312	14942
1940	26154	3632	22522
1960	35900	8800	28100
1980	59667	13406	46162
1996	83165	29627	53538
2012	89000	43000	46000

Po të shohim me vëmendje statistikën e mësipërme vërehet qartë që numri i popullsisë në rrethin e Pogradecit është rritur ndjeshëm, por ajo që mbetet për tu theksuar është pothuajse barazimi i numrit të popullsisë në fshat me numrin e banorëve në qytet (si pasojë e migrimit të brendshëm). Kjo ka ardhur si pasojë e një sërë faktorësh ku më kryesori është hapja e fronteve të punës në qytet mirqënja më e mirë etj.

### 2.3 Pasuria etnografike.

Pogradeci përbëhet nga një sërë tiparësh etnografikë të cilat e dallojnë atë nga zonat e tjera të Shqipërisë. Këto vlera janë krijuar në procesin e gjatë historik, si një kod që përcakton identitetin dhe rregullon marrëdhënjet ndër individuale dhe kolektive, duke përcaktuar role të qarta në shoqëri. Aspekti më i rëndësishëm i etnografisë së krahinës është familja, struktura e saj dhe ndërtimi i marrëdhënjëve brenda saj. Familja pogradecare është karakterizuar nga patriarkalizmi ku burri kishte një sërë të drejtash duke filluar që nga shitja dhe blerja e sendeve të dryshme, ndante detyrat në shtëpi për çdo antar të saj. Pra burrat kishin pushtet jo vetëm moral por edhe psikologjik dhe ekonomik. Familjet karakterizoheshin nga një numur i madh pjestarësh, ku respektoheshin pa masë të

moshuarit. Gruaja ishte e kufizuar nga një sërë të drejtash, ajo merr kryesisht me mbarvatjen e shtëpisë, dhe rritjen e fëmijëve. Fejesa është jo vetëm një moment gëzimi familjar, por është edhe më serioz për jetën e djalit dhe të vajzës. Ndaj koha e fejesës ishte një kohë parapërgatitore, morale dhe psikologjike për martesë. Kërkesat për fejesë shqyrtoheshin me kujdes. Kushdo që i hynte kësaj pune duhet të ishte i fjalës në mënyrë që ti mbushte mëndjen babait të vajzës, madje ai duhet të shkonte disa herë, sepse për të shtuar autoritetin familja e vajzës nuk e jepte fjalën kollaj. Në një ditë të caktuar ndërmjetësi vintë të merte përfundimin e çështjes dhe n.q.s ajo dilte me sukses shkelësi kthehej në shtëpinë e djalit dhe i dhuroheshin një palë këpucë (pasi kishte prishur të tija duke vajtur dhe ardhur). Për këtë merte shpesh herë edhe emrin këpucatar. Caktohej dita e ceremonisë së fejesës e cila ndryshonte sipas krahinës, fesë dhe ngritjes kulturore të qytetit ose fshatit. Kjo ditë quhej ndryshe edhe këmbimi i nishaneve, në të cilën këmbeshin dhurata të shumta midis dy palëve. *Martesa* ishte një tjetër evenim shumë i rëndësishëm. Dita e martesës vendosej me marrëveshje midis të dyja palëve dhe ishte e pa ndryshueshme. Si ditë dasme lihej e enjtja ose e djela. Regullat në marrjen e nuses ishin strikte. Rregulli I parë dhe kryesori ishte që krushqit që do të merrnin nusen duhet të ishin numur

tek. Në traditë ka qënë 9 ose 11 ndërsa sot është 5 ose 7. Tradita ishte që dhëndri nuk duhet ta shihte nusen deri ditën e dasmës. *Lindja* e një fëmije pa dyshim që ishte ngjarja më e gëzueshme dhe më e rëndësishme e një çifti. Riti i lindjes në qytetin e Pogradecit ka patur këto tipare: Së pari kur linte femija i parë dhe ishte djalë gëzimi shprehej në mënyrë të hapur dhe ceremonia familjare merte përmasa të mëdha. Së dyti, gëzimi për lindjen e djalit ishte shumë i madh e sidomos kur ai vinte pas disa vajzave. Mbivlerësimi i gjinisë mashkullore nuk lidhej vetëm me krahun e punës po edhe me trashigimin e mbiemrit të fisit dhe jetëgjatësinë e tij.

## 2.4 Kultura dhe arsimit

Populli i rrethit të Pogradecit ka trashëguar në shekuj një kulturë të lashtë. Në kërkimet e ndryshme arkeologjike në fshatin Selcë e Poshtme janë zbuluar monumente të rëndësishme ku del në pah identiteti i kësaj krahine. Një ndër elementë më të spikatur që përbejnë këtë kulturë janë punimet artizanale. Ato janë të shumta në numur dhe stilet e përdorura. Pogradeci qënë ndër të parat qytete të cilat ka hapur bibliotekë, teater dhe kinema. Në fushën e arsimit Pogradeci ka shënuar një tjetër arritje, duke bërë qyteti I dytë në Shqipëri që hapi shkollën shqipe.



ka  
u

Fig.nr 3 ( Vath ari shek III p.k) •Arsimi Gjatë pushtimit osman si dokumenta të vjetra të cilat e dëshmojnë zhvillimin e arsimit dhe kulturës këmi shënimet e lëna nga Evliha Celebia ku shkruhet: “Pogradeci” ka qënë shkollë filllore dhe një detyrueshëm mësimin e gjuhës turke, ato ishin kryesisht shkollë fetare. Por aritja më e madhe do të ishte hapja e shkollës së dytë shqipe më 14 mars 1887, në fillim me 11 nxësës. Një ndihmësë të konsiderueshme për këtë dhanë emigrantët e shumtë në Rumani, Bullgari etj të cilët sillnin libra. Mjerisht kjo shkollë nuk pati, jetë të gjtë sepse administratorët osman e mbyllën atë. Në vitin 1945 pasi vëndi u stabilizua nga luftat e shumta në Pogradec u ndërtuan dy shkollë me afro 15 mësues. Në këtë perjudhë qëllimi kryesor ishte që tëzdukej analfabetizmi dhe u bë i detyrueshëm arsimit 7–vjeçar. Nga viti 1990 dhe deri më sot në Pogradec ka 10 shkollë fillore, dhe po kaq 9 vjeçare, 3 gjimnaze ku njëri prej tyre është gjimnaz profesional si dhe 3 universitete ku dy prej tyre janë private.

Figurat e njohura të

këtij qyteti Qyteti i poetëve dhe piktorëve, kështu është quajtur Pogradeci për vetë faktin se ka nxjerë disa prej shkrimtarëve më të njohur të vëndit si L Lazar Gusho ( Lazgush Poradeci) dhe Mitrush Kuteli të cilët kanë krijuar vepra më vlera të mëdha letrare ndërsa një prej piktorëve përfaqësues është Anastas Kostandini ( Taso). L Lazar Gusho lindi më 27 dhjetor të 1899 në Pogradec. Njihet si një prej lirikëve më të mëdhenj i cili u shqua për sensibilitetin dhe ëmbëlsinë poetike. Temat e tij të preferuara ishin dhimbja dhe dashuria të cilat janë sa të kundërta aq edhe të afërta. Ai vdiq më 12 nëntor të 1987, duke lënë pas vepra artistike të nivelit më të lartë. Por Lazgushi nuk ishte vetëm poet por edhe piktor. Në nder të kësaj figure sot Qendra e Kulturës së qytetit mban emrin e tij. Lazgushi e ka pohuar vetë se n. q. s ai nuk do të kishte lindur dhe jetuar në Pogradec atëhere ai nuk do të kishte qënë dot kurrë poet dhe piktor.

Mitrush Kuteli emri i tij i vërtet ishte Dhimitër Pasko. Lindi më 13 shtator të 1907 në Pogradec. Ka qënë shkrimtar përkthyes dhe ekonomist. Studimet e mesme i kreu në Selanik kurse të lartën në Bukuresht, ku në vitin 1934 mori titullin **Doktor i Shkencave Ek**

Kuteli është një prej themeluesve të prozës moderne shqipëtare. Në nder të tij sot biblioteka e qytetit quhet Mitrush Kuteli. Para tre vjetësh është ndërtua sheshi i monumenteve, në qëndër të qytetit, i cili përbëhet nga dy monumente. Një është monumenti i L. Poradecit dhe tjetri që qëndron përball tij është monumenti i Mitrush Kutelit me një vlerë totale investimi prej 20.000.000 lek të reja. Pogradeci do të vazhdojë të mbetet një qytet i cili frymëzon artistët për të ndërtuar vepra artistike të pa harrueshme.

## 2.5 Zhvillimi i ekonomisë ndër vite dhe degët e saj.

Në trevat e Pogradecit zhvillimet ekonomike njohën lulëzim që tek enkelenasit e ilirisë. Ata ishin bujq e blektorë të mirë, tregëtar të mëncur si dhe peshkatarë e zejatrë të zotë. E jo vetëm kaq. Ata ditën të shfrytëzonin pasuritë e shumta nënëtokësore si qymyrin, hekuri, etj si dhe lëndët e ndërtimit argjil, rërë etj. Pyjet e shumta e të larta janë përdorur për përpunimin e drurit për ndërtim dhe për punime të ndryshme artistike. Flora është e pasur ,gjë që ka krijuar që së lashti traditën popullore të mjekimit dhe parandalimit të sëmundjeve të ndryshme. Të shumta janë dhe bimët aromatike. Të gjitha këto janë përdorur për industrinë e vëndit dhe për eksport. Pogradeci sot shquhet për pentari, perimtari, vreshtari. Kështu molla, dardha, kumbulla, arra gështenja etj janë të kultivuara pothuajse në të gjithë zonën. Rrushi vjen si traditë e lashte që nga enkelenasit. Për rrushin dhe verën e ilirëve flasin shumë historjanët e antikitetit. Në Pogradec vreshtaria u

zhvillua edhe gjatë pushtimit turk ,ndonëse islamizimi e ndaloi konsumin e verës. Sot në Pogradec pothuajse cdo familje ka një but në të cilin prodhon verë në mënyrë artizanale por dhe e eksporton atë.Por dhe përpunimi i lëndëve të ndryshme ishte I rëndësishëm dhe për këtë u ngritën punishte të shumta zejtarie, në të cilat prodhoheshin armë mjete peshkimi, qilima etj. Prodhimet e zejtarisë kanë tiparë teknike dhe stilistike origjinale të zonës. Në shek XIX zejtaria u zgjerua dhe me dyqane të robaqepësve, këpucarëve, marangozve, hekurpunuesve etj.Pas clirimit zejtaria u fuqizua shumë, duke u ngritur dhe një ndërmarje e posacme e artizantatit.Një pjesë e prodhimeve të saj ,si soba e karike bashkë me dhomat e gjumit dhe bufetë u bënë shumë të kërkuara në vënd.Për vite me radhe industria minerale si dhe ajo energjitike kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm jo vetëm për rajonin por për të gjithë vëndin.Peshkimi ka qënë por dhe eshte një nga degët kryesore të ekonomisë.Qoftë më metodat e reja apo edhe me ato të vjetra peshkimi shihet si burim tëardhurash por dhe si sport. Mbas viteve 1992 u nderpre ne pergjithesi i gjithe aktiviteti dhe u mbyllet rreth 80% e ndermarjeve ekzistuese. Nga viti ne vit banoret filluan te investojne ne drejtim te turizmit. Ne qytet u vu re nje fluks ndertimesh kryesisht banesa vetjake, hotele e restaurante. Vitet e fundit nisur nga pozicioni gjeografik dhe nga percaktimet e bera nga disa studime per qytetaret pogradecare, u kthjellua **vizioni i qytetit:** ”Ardhmeria e qytetit dhe permiresimi i jetes se qytetareve do te realizohej nepermjet zhvillimit te turizmit“.Objektet turistike u ndertuan brenda qytetit dhe pergjate bregut të liqenit të Ohrit. Kapacitetet që ofron rajoni Pogradeci sot janë:35- subjekte hotelerike. Gjithashtu edhe mjaft familje pogradecare ofrojne banesat e tyre për pushuesit por që nuk ekziston asnjë e dhënë rreth numurit te tyre. Sherbimi qe ofron Pogradeci per pushuesit ndahet në turizem hotelerik dhe familjar. Të dhena per turizmin hotelier janë të sakta , per ate familjar te dhenat jane shume te pakta, per mos thene te pastuduara.Ne turizmin hotelier Ne qytet jane: 12 hotele dhe kapacitetet e tyre jane te evidentuara ndërsa në të gjith rajonin ato bëhen 35 .Pogradeci kryesisht vizitohet nga pushues vendas të përhershëm të cilët tashmë kanë krijuar lidhjet me familjet pogradecare. Por pushuesit e huaj në përgjithësia janë vizitorë ditorë ose për një periudhë të shkurtër.Për vitin 2005 qyteti është vizituar nga afro 100 mijë turistë vendas e të huaj (burimi i informacionit MRTKS, pikat doganore në qytet, hotelet).Në vitin 2012 ky numur mendohet të jetë 150 mijë për gjatë gjithë vitit.

### Kapitulli III: Zhvillimi I turizmit dhe rëndësia e tij në qytetin e Pogradecit

Dihet tashmë se Pogradeci është një qytet turistik. Ai mundëso zhvillimi e një sërë degëve të turizmit si pasoj e pozites gjeografike, historisë dhe lashtësisë që ajo mbar, po dhe klimës. Të gjitha këto në vite me radhë tërheqin më mira turistë jo vetëm vendas po edhe të huaj. Tashmë zhvillimi i turizmit në këtë zonë është kthyer si një nga prioritetet më të rëndësishme jo vetëm të pushteti lokal por edhe atij qendror. Kjo degë e ekonomisë tashmë, sjell cdo vit nivele mjaft të larta të ardhurash jo vetëm për bizneset por edhe për bashkin dhe pushtetin qendror (me anë të pagimit të taksave nga subjektet turistike). Në pamundësi për të zhvilluar industri të tjera turizmi është kthyer tashmë si e vetmja mundësi për të zhvilluar ekonominë në këtë vënd. Nga viti në vit është rritur numri i subjekteve turistike të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Në nivelin e ekonomisë lokale efektet e turizmit janë mjaft të vlerësuar sepse ai ndikon në rritjen ekonomike, në stabilitetin e cmimeve, si dhe në krijimin e vëndeve të reja tëpunës. Faktorët kryesorë që përbëjnë dhe burimet e disponueshme të një vëndi për zhvillimi e turizmit janë:

- Burimet natyrore.
- Pasuritë historike, artistike dhe kulturore.
- Burimet njerëzore.
- Burimet në kapitale dhe në infrastrukturë.

Nga pikat e më sipërme ajo e cila ka nevojë për më shumë vëmendje është infrastruktura e cila në hyrje të qytetit le shumë për të dëshiruar. Përpjekjet e para për të ofruar burime njerëzore të kualifikuar në këtë fushë, kanë filluar. Me ndërtimin dhe funksionimin e Universitetit “Fan Noli” i Universitetit të Korcës, fakulteti i ekonomisë ofron studime në degën e turizmit e cila është një ndër më të preferuarit. Kjo do të bëjë që në një të ardhme të kemi personel të kualifikuar në ofrimin e shërbimeve turistike, cka do të ndikonte pozitivisht në një rritje edhe më të madhe të numrit të turistëve të cilët do të preferojnë këtë destinacion turistik për të pushuar.

#### 3.1 Historiku i zhvillimit të turizmit.

Turizmi shqipëtar është një ndër sektorët më delikat dhe ka shumë për të bërë në lidhje me të. Kjo degë e ekonomisë është relativisht e re dhe vëndit i mundon eksperjenca e gjatë në këtë fushë. Përpjekjet e para për ta zhvilluar turizmin në vëndin tonë i bëri Mbreti Zog. Në perdhujën në të cilën ai udhëhoqi vëndin u ndërtua disa hotele në Durrës, Frujë etj. Kjo ndoshta ishte perjudha e cila është ndoshta më e lulëzuar deri në atë kohë. Shteti për herë të parë u ndje i fuqishëm, u hapën rrugë të reja gjë që e lehtësonte lëvizjen nga një vënd në tjetri. U ndërtua



ujSELLSA lulishte dhe bulevarde. Por populli ynë ende nuk i kishte mundësitë për të bërë turizëm, sepse gjënja ekonomike si dhe trazirat e shumta politike nuk e krijonin këtë mundësi. Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist turizmi nuk pati vëmëndjen dhe zhvillimin e duhur. Në këtë perjudhë nuk lejoheshin turistet e huaj por vetëm disa udhëtar që vinin nga Europa lindore.

Pas prishjes së mardhënies Moskë –Tiranë edhe këto iniciativa morën fund. Për shkak të konflikteve politike të shumta vendi ynë u izolua tashmë. Hotelet e pakëta kishin fare pak klientë. Kishte më shumë shtëpi pushimi të cilat shërbenin më shumë për funksionarë të lartë të shtetit, për ata që vinin për vizita zyrtare nga jashtë dhe për punëtorë të dalluar.

Në vitet 70 si turistë ishin vetëm grupet komuniste nga vendet lindore. Ndërohtë që amerikanët ishin jo të preferuar.

Në vitet 80 infrastruktura turistike u mbështet nga shteti aq sa ishte e mundur, në këtë vend ku mungonte cdo gjë. Madje nga shteti u publikuan disa broshura, dhe u bënë përpjekjet e para që vendi ynë të njihej si destinacion turistik.

Në vitet 90 u shfaq një procedurë transformimi shumë i veshtirë i shoqëruar ky me probematika nga më të larmishmet të cilat si rezultat patën mbajtjen larg këtij vendi të turistëve të huaj dhe stepjen e turistëve vendas. Nga perëndimoret, Ballkani konsiderohej shumë i rrezikshëm.

Pas kësaj periudhe shumë problematike turizmi janë zhgjidhur por dhe shumë të tjera janë ende pa zhgjidhje.

Ndryshimi kryesor i Shqipërisë nga vëndet e tjera të rajonit në këtë fushë, është thjeshtë se ajo është më pak e zhvilluar dhe më e vonë. Kjo prej faktit se Shqipëria është një vend i vogël i cili ka pësuar për afro 40 vjet izolim total, ndërko që vëndet e tjera të botës kishin tashmë ndërtua bazat mbi të cilat ecte dhe zhvillohej dega më e re dhe e vjetër ndoshta e ekonomisë. Por Shqipëria pavarësisht se është e vonuar në kohë ka ende shumë mundësi për ta kthyer turizmin si degën prioritare të ekonomisë, kjo për vetë faktin se është një vënd me një sipërfaqe të vogël, ca lehtëson manaxhimin e saj, si dhe ba kulturë historie dhe burime natyrore mjaft të larmishme.

Një pikë tepër delikate e cila duhet kuruar sa më parë të jetë e mundur është i mazhi i Shqipërisë në rajon , Evropë e më gjerë. Duhet punuar fort që vendi jonë të mos konsiderohet i pasigurtë. Shqipëria duhet konsideruar si destinacioni më i ri turistik dhe duhet të rritet numri i turistëve, një njohje më e mirë dhe një përmirsim imazhi.

Nëse të gjitha burimet do të ishin shfrytëzuar dhe mirëpërdorur Shqipëria do të ishte në një tjetër situatë ekonomike

•Historiku i zhvillimit të turizmit në qytetin e Pogradecit.

Pogradeci, me pozicionin e tij gjeografik si dhe rrugët që kalonin në të bënin të mundur lidhjen e perëndimit me lindjen, dhe në saj të pamjes së tij piktoreske, buzë liqenit të Ohrit që herët ka tërhequr vëmëndjen e udhëtarëve të ndryshëm. Informacione të hershme për Pogradecin i gjejmë në librin e Evlia Celebisë "Udhëtimet". Ai ishte një udhëtar turk i shek XVII i cili bënte një përshkrim të qytetit ku ndër të tjerash ai shprehet imahnitur nga bukurit.

Në vitin 1927 Pogradeci mori një zhvillim të madh në të u ndërtuan 2 hotele, 4 hane mjeshtëri të shumta si zdrukthtarë, hekturpunues, argjendarë. Qyteti në këtë periudhë fillohej të zhvillonte "turizmin". Me ngritjen e hoteleve filloi të frekuentohej turizmi veror, por në këtë kohë filloi për herë të parë edhe lëshimi i shtëpive me qera për pushuesit. Me sa duket fluksi turistik ka qënë i konsiderueshëm. Kjo periudhë ishte e lulëzuar edhe nga aspekti kulturor dhe artistik me ndërtimin e teatrit, kinemasë etj, këto përbënin pse jo disa arsye më tepër për të vizituar këtë vënd. Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist turizmi nuk shihej si degë për zhvillimin e ekonomisë pas primare ishin zhvillimi i industrive të rënda. Privilegjin për të bërë pushime në atë kohë e kishin vetëm politikanët ose puntorët e dalluar.

Pogradeci ka qënë i frekuentuar në këtë kohë edhe nga vetë figura kryesore politike e asaj kohe Enver Hoxha. Ai e preferonte shumë këtë vënd aq sa vinte katër herë në vit për të pushuar. Në këtë periudhë fillohen të ndërtohen kampet e pushimit të cilat ishin të tejm bushura në sezonin veror. Dhe gjatë kësaj periudhe dominonte turizmi veror ndërsa degët e tjera të tij pothuajse nuk njiheshin nga pjesa më e madhe e popullatës.

Pas viteve 90 me ndryshimin e sistemit politik ekonomik dhe social, filloi të kuptohej rëndësia e zhvillimit të turizmit. Këtu filloi ndërtimi i një numuri të madh hotelesh sot janë rreth 35 të tilla. Tashme filluan investime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe jo vetëm. Po bëhen përpjekje të shumta që Pogradeci të jetë një destinacion turistik i cili të jetë i frekuentueshëm në të katërta stinët e vitit dhe jo vetëm në stinën e verës. Përpjekje të shumta po bëhen që turizmi të jetë i qëndrueshëm, duke ndërtuar strategji dhe politika të pështacme. Një mbështetje të madhe në këtë projekt po japin donatorët e huaj ku ai kryesori është Nehemia, i cili është një donator gjerman që ka kontribuar në bashkëpunim me qeverinë shqipëtare afro 10 milion euro për ndërtimin dhe funksionimin e kolektorit të ujërave të zeza të cila derdhe në liqen.

Bashkia e qytetit vetëm pak ditë më parë ka mar cmimin e “Turizmit Shqipëtar 2012” e akorduar nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve në bashkëpunim me Shoqatën Shqipëtare të Turizmit. Ky cmim u dha mbi bazë të përpjekjeve që bëhen nga ana e Bashkisë së këtij qyteti dhe banorëve të saj për ta zhvilluar akoma më shumë turizmin në këtë vënd. Por sigurisht që me marjen e këtij cmimi ky qytet duhet të bëjë përpjeke akoma më të mëdha në mënyrë që pse jo në një të ardhme jo shumë të largët ai të konkurojë dhë më vëndet e tjera jashtë kufijve Shqipëtar.

Fig.nr 4 Cmimi i turizmit



### 3.4 Analiza SËOT

Analiza SËOT nënkupton analizën e katër faktorëve në raport me konkurrentët, me segmentin e tregut ose me tregun në përgjithësi. Faktorët të cilët kanë ndikim pozitiv ose negative janë të brendshëm ose të jashtëm. Kjo analizë konsiston në fuqitë dhëdobësitë, mundësit dhe reziqet në zhvillimin e turizmit në qytetin e Pogradecit. Lidhur me këtë kemi si më poshtë:

Tabela nr.3.4.1 Analiza Sëot

Pikat e forta	Pikat e dobta
1. Pozita gjeografike	1 Problemet e shumta në infrastrukturë
2. Burime të mjaftueshme natyrore	2 Mos ofrimi nga ana e agjensive turistike si vend turistik
3. Funkionimi i sistemeve të kanaleve ujërave të zeza dhe kanaleve kulluese	3. Njohje e ulët nga vëndet e tjera
4. Ekzistenca e vlerave të traditës dhe kulturës	4. Konkurence e fortë me qytetet brënda vëndit si dhe me fqinjët
5. Klimë shumë e mirë	5. . Shkalla e lartë e informalitetit në Biznese turistike.
6. Ushqimi tradicional shumë i shijshëm dhe hapësirat e mëdha për larmi në këtë fushë.	6. Mungesa e marketingut profesional
7. Kombinimi degëve të ndryshme të turizmit duke përmendur turizmin liqenor, malor,	7. Mungesa e ndërmarrjeve të mëdha turistike.
	8. Mungesa e transportit uJOR me shtetin fqinjë.

kulturore etj. 8.Cmime të arsyeshme. 9.Prezenca e ujit të pishëm 24 orë.	9.Kufizime ligjore për zhvillimin e turizmit në liqen (mjete lundruese) 10.Mungesa e një shoqërie turizmi. 11.Mungesa e sinjalistikës orjentuese,informuese.
Mundësitë	Reziqet
1.Zhvillimi i turizmit 2. Bashkëpunimi ndërkuftar 3. . Bashkëpunimi midis bashkisë, bizneseve dhe pjesës tjetër të komunitetit 4. . Zhvillimi i turizmit familjar 5.Emigrantët e kthyer: potencial i burimeve njerëzor	1. Mungesa e bashkëpunimit midis forcave politike 2. . Ndryshime të shpeshta në legjislacion 3. Numër i pakët investuesish të huaj 4. . Konkurrencë e pandershme

### 3.3 Strategjia e zhvillimit 2007–2013

Një vëmendje e vecantë është kushtua turizmit dhe zhvillimit të tij në zonën e Pogradecit.Në mbështetje të këtij qëllimi është hartuar dhe po zbatohet Plani i veprimit të Turizmit në zonën e Pogradecit mbështetur nga Plani Strategjik i Bashkisë Pogradec.Një nga qëllimet kryesore të këtij plani ishte **“Zhvillimi i turizmit në promovimin të traditave kulturës dhe historisë”**,kjo bazuar edhe në ligjin e turizmit.Në hartimin e këtij plani morën pjesë ekspertët më të mirë të zonës në këtë fushë.Tre janë shtyllat kryesore në të cilat mbështete ky plan: 1.Biznesi i sektorit privat i përfshirë direkt në shërbimet turistike. 2.OJF–të të përfshira në zhvillimin e ngjarjeve apo aktiviteteve të cilat tërheqin turistë. 3.Zyra e qeverisjes lokale.

Ky plan është ndërtuar duke analizuar dhe patur parasysh për komponente kyç të zonës:

1.Tërheqje turistikë ngjarje dhe aktivitete,në të cilën përfshihen: vende historike, muzeume bukuri,natyrore të vecanta , përvjetore, festival ngjarje sportive dhe kulturore.2.Marketingu dhe promovimi i turizmit.Kjo përfshin mjetet dhe metodat e përdorura,për të tërhequr turistët si reklama,broshura,artikuj revistash, video,qendra informacioni për turistët.3.Infrastruktura

turistike,përfshin shërbimet bazë komunale dhe lehtësimet e disponueshme për turistët gjatë udhëtimeve të tyre në zonën tonë,sic janë rrugët zonat e parkimit,sinjalistika,uji, elektriciteti.Një mungesë e këtyre elementëve ose një kualitet i dobët i infrastrukturës mund tëshkurtojë kohën e qëndrimit .

4.Mikpritja turistike ( informimi dhe trajnimi) i referohet se si turistëve u është shërbyer,kjo përcakton nga ana tjetër edhe se si ka qënë eksperjenca e turistëve gjatë qëndrimit të tyre në këtë zonë.5.Shërbime të vogla

turistike,përfshinë të gjitha shërbimet që plotësojnë nevojat bazë të turistëve në zonë,hotele motele kampingje restorante.

Duke u mbështetur në këtëo pesë pika është analizuar për secilën prej tyre problematikat që ato kanë si dhe harkun kohor mënyra e zgjidhjes ,por dhe koston finacjare që ato do të kënë.Renditja e problemeve ështëbërë mbi bazë të numrave .

Të gjitha planet zakonisht përmbajnë qellimin dhe objektivat që secili të jetë dakort me ndryshimin e situatës aktuale.Fatketëqisisht shumë plane nuk përfshijnë plane të detajuara,që të cojnë në arritjen e këtyre qëllimeve dhe objektive.Për të kapërcyer këtë barjerëky plan zhvillimi është mjaft specific.Për secilën objektive do të bëhet i mundur analizimi, monitorimi,dhe vlerësimi.

Tabela.nr.3.3.1 Problematikat e hasura gjatë analizës

Problematikat (tërheqje turistike ngjarje dhe aktivitete)	Problematikat (të promovimit të turizmit)
<p>1.Kurora e cpyllëzuar.(aktiviteti jo ligjor në prerjen e drurëve)</p> <p>2.Pastërtia dhe mirmbajtja e liqenit</p> <p>3.Mungesa e organizimit dhe planifikimit të aktiviteteve kombëtare në Pogradec.</p> <p>4.Mungesa e transportit ujqor në liqen me shtetin fqinjë.</p>	<p>1.Mungesa e përfshirjes së zhvilimit të turizmit në Pogradec, në prioritetet e qeverisë.</p> <p>2.Mos përfshirja e Pogradecit si destinacjon turistik nga tour–operoret vëndas dhe të huaj.</p> <p>3.Mungesa e shoqërisë së turizmit.</p> <p>4.Mungesa e broshurave fletëpalosjeve , ëeb site për hotelet dhe qytetin.</p> <p>5.Mungesa e panairove për promovimin e vlerave.</p>

Nga problematikat e më sipërme disa prej tyre u është dhënë zhgjidhje.Problemi i pastrimit të liqenit tashmë i është dhënë një zhvgjidhje shumë e mirë, ndërtimi i kolektorit dhe impjanti të

ujrave të zëza që dëri pak vite më parë derdheshin në liqen. Një fond prej 10 milion euro dhënë nga ambasada gjermane në bashkëpunim me Bashkimin Europjan. Ky projekt tashmë është drejt fundit.

Tashmë është e kuptueshme që promovimi është një ndër elementët kryesor për të tërhequr turistët. Mbështetur në këtë pikë që prej 3 vjetësh Bashkia Pogradec ka një eeb të tijën ([www.bashkiapogradec.gov.al](http://www.bashkiapogradec.gov.al)) në të cilin vec të tjerash një rëndësie të vecantë i është kushtuar dhe promovimit të këtij qyteti. Në të shpalosen të gjitha ngjarjet dhe evenimentet e ndryshme që organizohen në këtë qytet. Gjithashtu nxjerja e fletëpalosjeve nga ana e Bashkisë tashmë po bëhet e përvitshme. Dhe hotele nuk qëndrojnë pas nga kjo anë. Pjesa më e madhe e tyre tashmë administrojnë faqen e tyre në internet ku turistët mund të prenotojnë shumë ditë më parë. Një tjetër arritje e cila është realizuar është organizimi i panairëve të ndryshme në këtë qytet, duke filluar që nga panairi i punimeve artizanale ku marrin pjesë jo vetëm artizanët e qytetit por edhe të gjithë krahinës, madje dhe nga vëndi fqinjë Ohri dhe Struga. Festa e verërave është shndëruar tashmë në një panair të verës artizanale e cila organizohet në datat 21 dhe 22 dhjetor.

Tabela nr. 3.3.2 Problematikat në infrastrukturën turistike si dhe në mikpritjen e turistëve.

Probleme në infrastrukturën turistike	Probleme në mikpritjen e turistëve
1. Mungesa e një plani urbanistik gjithëpërfshirës	1. Mungesa e bashkëpunimit shkëmbimit të eksperiencës me fqinjët.
2. Mungesa e infrastrukturës dhe parkingut në vëndet turistike historike.	2. Mungesa e trajnimeve profesionale përfshirë gjuhën e huaj.
3. Mungesa e sinjalistikës orjentuese dhe informuese.	3. Mungesa e femrave në shërbimin turistik.
4. Mungesa e lojrave për fëmijë	
5. Mungesa e ndricimit rrugor.	

Edhe në këto dy aspekte kemi zhvrijdhje e disa problematikave si : është hartuar tashmë plani urbanistik gjithëpërfshirës mbetet vetëm për tu miratuar nga organet kompetente. Një investim prej 1 milion lek (të reja) nga ana e Bashkisë ka bërë të mundur ndërimin e një parku lojrash për fëmijët i ndërtuar në një nga parqët pranë liqenit, në të cilin fëmijët mund të luajnë dhe argëtohen. Edhe përsa i përket ndricimit janë bërë përpjekje të shumta për ta shtrirë atë sa më shumë të jetë e mundur në rrugët kryesore dhe dytësore.

Falë bashkëpunimit shumë të mirë të Bashkisë Pogradec me atë të Ohrit dhe Strugës është bërë i mundur pjesmarja e këtyre të fundit në cdo evenimen që organizohet në këtë qytet, falë këtij bashkëpunimi janë shkëmbyer ide dhe mendime ku më kryesori ka të bëjë me ndërtimin e një porti të vogël në qytetin e Pogradecit. Kjo do të mundësonte jo vetëm shkëmbimin e mallrave por dhe në tërheqjen më të madhe të fluksit të turistëve.

Një numur i konsiderueshëm studentësh sot studjojnë në universitetin Fan Noli në Pogradec në degën e turizmit. Ky numur aktualisht është 100 student në total. Më shumë se 50% e studentëve janë femra cka tregon se në një të ardhme shërbimi i ofruar prej tyre nuk do të mungoj. Kjo jo vetëm në kontakte të drejtpërdrejta me turistët por pse jo edhe në organizimin e guidave profesionale në këtë zonë e cila ka se çfarë tju ofrojë turistëve në cdo kohe.

Tabela.nr 3.3.3 Probleme të shërbimeve turistike dhe tregëtare.

Problemet të shërbimit turistik dhe tregëtar
1.Mungesa e muzeve për vlerat historike.
2.Mungesa e zyrës së informacionit turistik.
3.Mungesa e agjensive turistike dhe paketave turistike
4.Mungesa e shërbimeve (bare, pub etj) me orare të zgjatura.
5.Mungesa e fshatrave turistik.
6.Mungesa e guidave
7.Mungesa e dyqaneve për suvenire të traditës.
8.Cmime të larta krahasuar me fqinjët
9.Shërbimi i internetit i dobët.

Problemet e zgjidhura.

Bashkia e Pogradecit ka hapur tashmë prej 2 vitesh Zyrën më të re të Informacionit të Turizmit, duke e vlerësuar si një faktor shumë të rëndësishëm për nxitjen dhe zhvillimin e turizmit, si një burim kryesor për punësimin dhe zhvillimin ekonomik të qytetit. Iniciativa është një shembull konkret i një partneriti publiko-privat mes Bashkisë së Pogradecit dhe kompanisë Çelësi, me mbështetjen edhe të USAID.

Kompania Çelësi ka marr përsipër jo vetëm pajisjen e zyrës, punësimin e stafit, por edhe

menaxhimin dhe mbarëvajtjen e Zyrës së Informacionit të Turizmit (ZIT) me shpenzimet e saj. Çelësi ka eksperiencë në ofrimin e shërbimit për informacionin turistik në Shkodër, si dhe në Vlorë e Sarandë. Në këmbim të kësaj, Bashkia siguroi vendin dhe godinën e nevojshme për ZIT, e cila do të bëjë të mundur transformimin dhe përmirësimin e një sektori të rëndësishëm të ekonomisë së qytetit, si dhe do të jetë një instrument për rritjen e investimeve private dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik vendor. Kjo zyrë i vjen në ndihmë një numri të madhtë turistëve. Sot në këtë qytet janë 3 dyqane të cilat shesin suvenire të ndryshme për turistët, ku ndër më të preferuarat janë pikturat me pamje nga liqëni, por nuk mungojnë dhe punimet prej druri dhe punë ndoret e ndryshme të bëra nga gratë e kësaj zone si një tradite e trashëguar brez pas brezi, por që për fat nuk po ruhet nga brezi i ri. Tashmë shërbimin e internetit mund ta gjesësh kudo qofte nga internet kafe të ndryshme që janë hapur, por edhe në hotele ku turistët preferojnë të akomodohen. Persa i përket cmimeve ato janë stabilizuar tashmë, dhe krahasuar me vëndin fqinjë ndoshta janë edhe më të luta. Një paketë turistike 2 ditore duke përfshirë akomodimin mëngjesin drekën dhe darkën kushtor afërsisht 9.000 lek personi. Ky Plan Veprimi për zhvillimin e turizmit në zonën e Pogradecit ka arritur të zhgjidhë disa prej problematikave por mbetet ende shumë punë për tu bërë në mënyrë që kjo zone të ketë një zhvillim të qëndrueshëm pasi ky ishte dhe qëllimi i krijimit të këtij plani.


Ende sot Pogradeci mbetet një destinacion turistik i mbi frekuentuar në sezonin veror pavarësisht përpjekjeve të shumta të bëra nga ana e Bshkisë, për ta shtrirë atë gjatë gjithë vitit.

### 3.2 Degët e turizmit të cilat mund të zhvillohen në këtë zonë.

Qyteti i Pogradecit i vendosur buzë liqenit të Ohrit, siguron të gjitha mundësitë për të qënë një qëndër turistike që ofron shërbime për zhvillimin e turizmit, të banjove liqenore si dhe të turizmit klimatik. Gjithashtu një forcë të madhe tërheqëse, paraqet edhe vetë liqeni, i cili ka ujë të pastër dhe është një ekosistem me specje të rralla.

Fig.nr 3.2.1 Degët e turizmit të cilat zhvillohen në qytetin e Pogradecit





Këto degë janë deri më sot më të

zhvilluara në këtë qytet, ku kryesori sigurisht që është turizmi liqenor ose i quajtur ndryshe turizmi blu.

Turizmi gastronomik. Pogradeci njihet për gatimet e tij krejt të vecanta. Vetëm më koranin peshkun e rrallë të liqeni bëhen 10 gatime të ndryshme. Por nuk mbeten pas edhe lakrori me dy petë, petullat e fshira, petaniku si dhe vera e bardhë dhe e kuqë por dhe rakia e prodhuar në mënyrë artizanale. Turizmi arkeologjik dhe kulturor. Zona e Pogradecit ka dy zona arkeologjike të një rëndësie të vecantë, Varret Monumentale të Selcës së Poshtme si dhe mozaikët e Linit. Varret Monumentale të Selcës janë unike në të gjithë botën në pikpamje të arkitekturës dhe mënyrës së ndërtimit. Datojnë 400 vjet para Krishtit. Ndodhe 40 km larg qytetit të Pogradecit. Varret janë vendosur në një kodër të latër mbi fshatin Selcë. Ato paraqesin skena të bëmave të mbretërve ilir në luftë me maqedonsit e lashtë. Në njërin prej tyre thuhet se është varrosur Kliti, mbreti ilir i Pelionit. Objektet që janë gjetur në të janë shumë të kushtueshme dhe ruhen në muzet e ndryshëm në Tiranë.

Fig.nr 3.2.1 Fibul

Fig.nr 3.2.2 Vath ari



Objekti: Fibu, materjali :ar, perjudha:epoka henelstike Objekti : vath , materjali: ar, perjudha: shek III para k

Mendohet se ende ka për të zbuluar në këtë vënd me kaq shum histori.Kështu që specialistët e kësaj fushe mund të vijnë dhe të hedhin më shum dritë në këtë vënd,por gjithashtu edhe turistët e thjesht për të mësuar me shum nga historia e këtij vëndi.Mozaikët e Linit, ndodhen në gadishullin e linit, datojnë në shek VI pas Krishtit.Ato ndodhen 22 km larg qytetit të Pogradecit.Lini mozaiku bizantin i shek VI–VII është mozaiku më i madh në Ballkanit, me një sipërfaqe prej 220 m katrorë.Ky mozaik ndodhet në tokë dhe ka disa figura si zogj, peshq e zbukurime të tjera të punuara me shumë finesë.

Vendet të cilat mund të vizitoni në Pogradec **Kalaja e Pogradecit** është e vendosur në majën e kodrës, në pjesën perëndimore të qytetit të Pogradecit, me lartësi 205m mbi nivelin e liqenit dhe 689m lartësi mbi nivelin e detit. Ajo ka qenë e banuar në shek. V. p.k., ndërsa në shek. IV p.k. kjo qendër banimi tipike Ilire u rrethua me mure mbrojtëse. Gërmimet arkeologjike në Kalanë e qytetit kanë zbuluar se banorët e kësaj krahine janë marrë me bujqësi, blektori, peshkim, zeje të ndryshme dhe kanë pasur mardhënie me qendërat e banuara fqinje. Ajo ka pasur një vjetërsi banimi prej 1400 vjetësh, duke qenë një kala iliro - shqiptare e hershme.Për fat të keq sot Kalaja është e rënuar në të gjenden shum pak gjurmë të ndërtimit. Muzeu i Pogradecit është një muze lokal me karakteristika arkeologjike, etnografike dhe historike.Objektet e ekspozuara në të përfaqësojnë të gjithë trevën e Pogradecit dhe i përkasin një epoke që fillon që nga epoka e Neolitit deri në shek XX të e.s.Pjesa e arkeologjisë zë pjesën më të madhe të ekspozesë.Ajo përmban materjale që datojnë nga mijecari i VII p.e.s deri në shek XVIII të e.s. Ekspozimi i objekteve eshte bërë bazuar mbi tipologjinë dhe kronologjinë e materjalit.Pjesa e etnografisë përfaqësohet nga objekte të përdorura në trevën e Pogradecit që nga mesjeta. Në to hynë, veshjet popullore si fustanella, këmisha, jelek, rip guna qeleshe të përdorura ndër shekuj nga burrat dhe gratë e kësaj krahine. Pjesa e ngjarjeve të historike përfaqësohet nga fotografi të perjudhës së Luftës së II Botërore , ku tregohen momente të ndryshme të kësaj perjudhe që nga pushtimi fashist ,formimi i cetave partizane, aksjonet luftarake momente nga lufta e deri në clirimin e Pogradecit. Numri I turistëve që kanë vizituar muzeun është:

Tabela .nr 3.2.1 Numri i vizitorëve në muze.

Viti	2012	2012	2012	2012	2012
Muajt	Korrik	Gusht	Fshtator	Tetor	Nëntor
Nr I	250	120	210	310	405

tuirstëve					
-----------	--	--	--	--	--

Kjo tregon se ende turizmi kulturor është në nivele të dobta zhvillimi, gjatë kohës që në këtë destinacion ka flukse turistike prej afro 45.000 deri 75.000 në periudhë korrik gusht vetëm 370 prej tyre vizitojnë muzeu e qytetit. Ndoshta kjo lidhet edhe me faktin se ky muze është celur në vitin 2011.

#### *Galeria e Arteve*

është një tjetër vend ku mund të gjejmë vlerat dhe traditat e jetës kulturore të qytetit të Pogradecit të shprehura në veprat e artit si piktura, skulptura etj... Ajo ndodhet në qendër të qytetit, në qendrën kulturore “Lasgush Poradeci”. Kjo galeri organizon gjatë gjithë vitit ekspozime me punime të ndryshme nga piktorë dhe skulptorët të shumtë pogradecarë, shqiptarë dhe të huaj. *Galeria e Pikturës “Atelie Taso”* është një tjetër galeri që ekspozon pikturat e piktorit të njohur pogradecar Anastas Kostandini (Taso). Kjo galeri është një galeri private e piktorit të njohur, por është e hapur të vizitohet nga të gjithë dashamirësit e pikturës dhe mozaikëve për të parë veprat vërtet madhësore të këtij artisti pogradecar.

*Mësonjëtorja* e parë në Pogradec u hap në 14 mars 1887, një javë pas hapjes së shkollës së parë shqipe në Shqipëri. Ajo u hap në shtëpinë e Sotir Shqiptarit (Hani i Paskos, i cili ndodhet në lagjen e “Toplecit”), me mësues Pandeli Sotirin dhe vitin e parë kishte një klasë me 11 nxënës, kurse vitet e tjera në vazhdim u zgjerua me më shumë nxënës dhe klasa. Mësonjëtorja e parë në Pogradec dhe e dyta në Shqipëri është akoma me po të njëjtën arkitekturë që kishte edhe atëherë. Por për fat të keq ajo tashmë është kthyer në një shtëpi banimi dhe nuk ofron asgjë për turistët përveç historinë e saj në të shkuarën. *Lagjia e Toplecit* njihet si lagjia më e vjetër e qytetit, që mban traditat e hershme, rrugicat me kalldrëm dhe vlera të mëdha arkitekturore. Kjo është një lagje që tregon vlerat dhe traditën e qytetit, në të ndodhet kisha e vjetër, shtëpia e lirikut të madh pogradecar, Lasgush Poradeci, themelet e shtëpisë së poetit të pavdekshëm, Mitrush Kutelit dhe shumë familje dhe njerëz të shquar

*Shtëpia e Lasgush Poradecit* ndodhet në lagjen tradicionale të qytetit dhe është një nga shtëpitë më të vizituara për shkak të vlerave që i jep vetë lirikut i madh, i cili pothuajse pjesën më të madhe të jetës së vet e kaloi aty dhe po në këtë shtëpi krijoi edhe pjesën më të madhe të kryeveprave të tij. Lasgush Poradeci është quajtur nga shumë kolosë të letërsisë botërore “Eminesku Shqiptar” për shkak të gjenisë së tij letrare. Kjo shtëpi sot është në një gjendje të mjerueshme e cila nga jashtë duket si një shtëpi e haruar ndër vite. *Themelet e shtëpisë së*

**Mitrush Kutelit** ndodhen në lagjen e “Toplecit”. Fatkeqësisht shtëpia u shkatërrua dhe tani kanë mbetur vetëm themelet e saj. Janë bërë shumë përpjekje dhe tentativa të ndryshme për ta rindërtuar këtë shtëpi sipas arkitekturës që kishte me qëllim për ta bërë një muze kulturor ku të pasqyrohet jeta dhe vepra e poetit pogradecar. Madhështia e krijimeve dhe veprave të tij i jep vlera të veçanta këtij vendi, për të gjithë vizitorët dhe turistët. Mitrush Kuteli nuk ka qenë vetëm një shkrimtar i madh, ai ka qenë edhe një gjeni në fushën e ekonomisë dhe për shumë vite ka qenë drejtor i Bankës së Shqipërisë, por kjo nuk ia largoi asnjëherë dashurinë e madhe për letërsinë dhe krijimet e mrekullueshme letrare. Turizmi kulturor dhe historik. Janë hedhur hapat e para për zhvillimin e kësaj dege të turizmit në ndërtimin e muzeut historik të rrihapur në 2011, është për të ardhur keq që një pikë turistike si Pogradeci të këtë investuar kaq vonë në këtë fushë.

Turizmi artizanale. Cdo vit në qytetin e Pogradecit zhvillohet Panairi Rajonal i Punimeve Artizanale. Punimet Tradicionale Artizanale janë padyshim veçantia e ç’do treve dhe e ç’do kombi, aty shprehet prejardhja kulturore e ç’do vendi dhe unikaliteti i tij. Për t’i ruajtur këto tradita, si dhe për t’i përhapur më tepër vlerat e këtyre punimeve artizanale,

Bashkia Pogradec ka organizura dhe ka mbështetur vazhdimisht takime, seminare dhe panire të ndryshme. Cdo verë në sheshin “100 Hapa Drejt Europës”, në qendër të qytetit të Pogradecit zhvillohet Panairi Rajonal i Punimeve Artizanale, me pjesmarrës nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe Kosovës. Gjatë datave 19-20 korrik jo vetëm qytetarët e Pogradecit, por edhe turistë dhe vizitorë të shumë të tij, kanë mundësinë ta vizitojnë këtë panair, që përmban një shumëllojshmëri të mrekullueshme punimesh artizanale nga treva të ndryshme të Shqipërisë dhe Kosovë. Gjatë vitit 2012, Bashkia e qytetit ka financuar me vlerën 385 000 leke te reja, për taksën e zënies së hapësirave publike për 4 muaj nga biznesmenet e punimeve tradicionale artizanale për të hapur “mini-tregun” e punimeve tradicionale me dorë. Kjo është një iniciativë që pushteti lokal i qytetit të Pogradecit i jep bizneseve të vogla në kohën kur fluksi i turistëve dhe vizitoreve arrin kulmin. Vendosija e këtyre bizneseve të vogla për tregëtim, në vendin më të frekuentuar nga turistët, përgjate shetitores së plazhit ka qenë një mbështetje tjetër që Bashkia u ka dhënë atyre. Për organizimin e këtij panairi Shoqata e Zejtarëve dhe Mjeshtrave Duartartë Pogradec, ka paguar një taksë 33 000 leke te reja për marrjen e lejes për tregëtim të mallrave. Në fund të këtij panairi Bashkia Pogradec sponsorizoi çmimet fituese për produktet më të mira artizanale, të cilat kapën vlerën totale, 35 000 leke te reja. Këto çmime jepen për të inkurajuar dhe për të mbështetur më tepër bizneset e vogla artizanale në Pogradec.

Tabela nr.3.2.2 Zhvillimi i Panairit Artizanal në Pogradec, ndër vite.

Viti i zhvillimit te panairit	Numri i vëndeve pjesamrëse	Numri i bizneseve pjesmarëse
2010	Korca , Elbasani, Librazhdi, Përenjasi, Pogradeci	9 biznese
2011	Korca, Stroga, Ohri, Kosaova Pogradeci, Përenjasi, Librazdi	12 biznese
2012	Korca, Pogradeci, Kosova, Shkodra, Elbasani, Herseka, Librazdi, Përenjasi, etj	20 biznese

Sic vërehet edhe nga të dhënat e tabelës, numri i pjesëmarrësve në këtë panair sa vjen edhe rritet. Kështu në vitin 2010 kishim vetëm pesë vënde pjesëmarrëse, ndërsa në vitin 2011 ky numur ka shkuar në shtatë vënde, viti 2012 ka qënë më i suksesshëm me afro dhjetë vënde pjesëmarrëse. E gjitha kjo sjell një konkurrencë më të madhe cka do të thotë edhe produkte më cilësore për tu hedhur në këtë treg i cili po mikpritet nga një numur i madh turistësh. Edhe numri i bizneseve të cilat kanë marrë pjesë në këtë panair është në rritje, ku sigurisht që pjesën më të madhe e zenë bizneset të cilat përfaqësojnë rajonin e Pogradecit dhe nxjerin në pah produktet e punuara nga kjo zonë. Ky panair bën të mundur që vlerat e këtij qytetit dhe jo vetëm, të trashëgohen brez pas brezi dhe të ruhen me fanatizëm. Gjithashtu rëndësia kryesore e këtij panairi është që të rrisë vëmendjen e turistëve duke i treguar se në këtë qytet ka kulturë të lashtë. Kjo është pse jo edhe një përpjekje më shumë për ta bërë turizmin në këtë qytet edhe më të qëndrueshëm duke u fokusuar te punimet artizanale cka tregojnë edhe një pjesë të kulturës.

Turizmi i bazuar në aktivitete ( festa lokale dhe aktivitete )

1. Festa e verës. Qyteti i Pogradecit historikisht ka pasur një jetë aktive dhe dinamike për pasojë është edhe qyteti që ka dhe mbart tradita të shumta me vete. Në shekullin e XIX qyteti i Pogradecit quhej, “Qyteti i 11 Mullinjve” sepse përgjatë “Lumit të madh të qytetit”, siç e quante Lasgush Poradeci, dhe deri në luginën e Katielit, shtriheshin 11 mullinj.

Qyteti është shquar për teknikën e lartë të punimit të varkave, në peshkim, në gëdhendjen e gurit dhe në ndërtimtari, në pemtari (ku një pjesën të madhe e ka zënë kultivimi i gështenjave ).

Pogradeci historikisht është marrë me kultivimin e vreshtave dhe varietete të ndryshme të rrushit dhe kanë prodhuar me një teknologji të lartë rakinë dhe verën. Qytetarët e tij kanë prodhuar me mjeshtëri të rrallë dhe në mënyrë artizanale shumëllojshmëri verërash në bodrumet e shtëpive të tyre, duke i kthyer në kantina. Butet e verës në kantinat e tyre arrinin deri në 50kv dhe me lartësinë e tyre arrinin deri në tavanin e kantinës. Ato ishin prej druri dhe punoheshin me dru Robulli ose Dushku. Familjet që janë marrë me prodhimin e verërave janë të shumta. Këto familje kanë prodhuar edhe shumëllojshmëri pijesh të tjera, ku dallon pija e rakisë, e cila prodhohej nga rrushi, mani, kumbulla etj.

Qyteti sot ka si prioritet zhvillimin e turizmit dhe njohjen e vlerave turistike të qytetit edhe në sezonin dimëror, peisazhet e mrekullueshme me dëborë, liqenin e “egërsuar” nga dallgët dhe njohjen e vlerave tradicionale pogradecare. Bashkia e qytetit Pogradec, në vazhdimësi të traditës pogradecare të prodhimit të verërave, organizon atmosferën festive në qytet për konkursin dhe promovimin e verës më të mirë pogradecare në “Festën e Verërave”. Prodhimi i verës së bashku me vreshtarinë janë disa nga traditat dhe zakonet e shumta të jetës së përditëshme të qytetit të Pogradecit, nga kohët më të hershme (diçka që tregohet edhe në mozaikun e Linit) dhe deri në ditët e sotme. Bashkia e qytetit Pogradec në kuadër të ruajtjes dhe zhvillimit të vlerave kulturore, traditave dhe zakoneve pogradecare dëshiron që festa e verës pogradecare të ketë një shtrirje më tepër se lokale duke u përpjekur që përveç traditës së prodhimit të verërave të bëjë të njohur edhe ngrohtësinë e mikpritjes, dashamirësinë dhe pjesazhet e bukura natyrore të Pogradecit në stinën e dimrit. \*Kjo festë në këtë qytete bën të mundur:

1.Promovimi dhe zhvillimi i turizmit në të katër stinët e vitit nëpërmjet promovimit të vlerave qytetare.

2,Ruajtja dhe forcimi i traditës përmes organizimit të festës së verërave si një festë tradicionale e qytetit.

\*Përfituesit e këtij evenimenti janë:

1.Banorët e qytetit të Pogradecit, të rajonit dhe mbarë vendit.2.Institucione dhe biznese të ndryshme lokale, rajonale dhe kombëtare.

\*Objektivat që duhet të arrihen me anë të zhvillimit të kësaj seste janë:Promovimi dhe zhvillimi i turizmit në të katër stinët e vitit nëpërmjet promovimit të vlerave qytetare.Zhvillimi i biznesit vendas dhe rajonal.Inkurajimi për ruajtjen e traditave dhe vlerave të qytetit të Pogradecit edhe nga brezat pasardhës\* Rezultatet

e pritshme janë :

Promovimi më

i gjerë i turizmit të Pogradecit edhe në stinën e dimrit. Njohja e traditave nga brezat pasardhës. Krijta e të ardhurave për prodhuesit e vegjël artizanale të verërave përmes promovimit të produkteve të tyre dhe gastronomise vendase të traditës. Më shumë vizitorë në qytet. Por e gjitha kjo festë tradicionale tashmë kërkon edhe një buxhet të posaçëm nga ana e pushteti lokal, dhe ajo është si më poshtë.

Tabela.nr 3.2.3 Totali i buxhetit në lek për festën e Verës në qytetin e Pogradecit

	Zerat	Total
1	Pagesa per Jurine e degustimit 5 persona * 2000 leke	10.000
2	Cmimi per veren fituese (e kuqe dhe e bardhe) 2x2000	4000.000
3	Cmimi per poezine me te mire	10.000
4	Pagesa per grupin e kenges Pogradecare ( 2 nete * 10.000)	30.000
5	Koncert me kengetare te njohur 150000	150000.000
6	Pagese per Hekuran Pre	9.000
7	Pagesa per grupin egajdeve	15.000
8	Pagesa per nevoja te jurise	4.000
9	Spoti me Median Kombetare (ALSAT-TVSH-TOP CHANEL)	70.000
10	Spoti ne televizionin SOT	15.000
11	Njoftime sipas nevojës per komunitetin lokal	10.000
12	Banderola 4 cope * 6. 000 leke	24.000
13	Flamuj per festen everes 10 flamuj * 1.500 leke	15.000
14	Bute te vegjel me logon e festes se vererave	50.000
15	Ftesa, adesive, diploma etj	15.000
16	Koktejl per pritjen e te ftuarve ne zyren e kryetarit	30.000
17	Transport per nevoja te festes	20.000

18	Fishekzjarre	100.000
	TOTAL	154427.000

I gjithë oragnizimi kap një vlerë totale prej 154.427.000 lek të reja. Kjo nuk është një shum e madhe por dhe e vogël nuk eshte duke patur parasysh që Pogradeci është një qytet i vogel me një buxhet i cili është mjaft i kufizuar. • Festivali i Teatrit të Kukullave “Xinxifilo”

Një tjetër aktivitete kulturere i cili organizohet cdo vit në Pogradec është , Festivali i Teatrit të Kukullave “Xinxifilo”

Festivali “Xinxifilo” është një aktivitet i organizuar nga Bashkia Pogradec, nën kujdesjen e presidentit të këtij Festivali dhe njëkohësisht themeluesi i “Xinxifilos”, z. Artan Shkëmbi. Në këtë eveniment të organizuar vetëm për fëmijët, mrrin pjesë 8 trupa teatrale, nga Shqipëria dhe Kosova, trupa teatrale private dhe trupa shëtitëse. Në të marrin pjesë trupat teatrale të Korçës, Pogradecit, Elbasanit, Ferizaj, Prishtinës, trupa e teatrit privat “Art Blu” nga Tirana, Beratit dhe Teatri Shëtitës. Shfaqet e teatrale zhvillohen nga data 25-30 qershor. Ky Festival organizohet cdo vit që nga viti 2002.

• 21 Qeshori dita e Liqenit celja e sezonit turistik veror. Kjo ditë është ndër më të vecantat në këtë qytete, me panairt e shumtë të suvenireve, gatimeve, bizneseve të ndryshme, restoranteve, galerive të artit, agjensive turistike, shoqatave të ndryshme OJQ që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Pogradec, me organizimin e një konkursi fotografish me nxënësit e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare publike dhe private, me gara sportive me biçikleta, kajota dhe me shumë aktivitete të tjera. Çelja e Sezonit Turistik është kthyer tashmë në një traditë festimi .Shpalosja e vlerave të shumta e sidomos atyre kulturere në qëndër të vëmëndjes këtë ditë janë edhe artistët e shumtë të qytetit.

• Festivali Ballkanik i Filmit dhe i Kulinarisë

Jeta e pasur me aktivitete të ndryshme kulturere, në qytetin e Pogradecit, vazhdon edhe pas përfundimit të sezonit turistik veror. Në qytet, zhvillohet edicioni i Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë. Ky aktivitet organizohet në datat 3-9 shtator, me pjesmarrjen e 9 shteteve ballkanike: Maqedonia, Serbia, Kosova, Bullgaria, Rumania, Greqia, Kroacia dhe Turqia. Gjatë këtyre ditëve, në kinemanë e qytetit, shfaqen filma me metrazh të shkurtër dhe me metrazh të



gjatë. Në këtë aktivitet përveç zhvillimit të artit dhe filmit një rëndësi të vecantë marrin dhe gatimet tradicionale të vëndeve pjesmarëse. Të gjitha këto përbëjnë një diversitet kulturash të cilat rijnë shumë mirë bashkë.


- 6 Janari Dita e Ujit të Bekuar Në këtë ditë besimtarët ortodoksë dhe katolikë, në Pogradec ashtu si dhe në të gjithë botën, festojnë ditën e Ujit të Bekuar, që njihet si dita e bekimit të Zotit. Sipas Biblës, kjo ditë përkon me mbrëmjen kur tre dijetarë panë në qiellin e Betlehemit në Jeruzalem, yllin, i cili paralajmëronte lindjen e Birit të Zotit, Jezu Krishtit. Të tre dijetarët, Melchiorri, Baldassari dhe Gasperi, u nisën nga vende të ndryshme për të parë dhe për t'i ofruar dhuratat e tyre Jezu Krishtit fëmijë.

Me rastin e kësaj dite, organizohen mesha, të cilat shoqërohen me lutje të ndryshme, me bekimin e ujit dhe marrjen e këtij uji nga besimtarët. Në thelb të kësaj dite është ceremonia e hedhjes së kryqit në ujë nga një klerik. Besimtarët më pas nxitojnë për të nxjerrë kryqin nga uji I liqenit të Ohrit. Sipas ritit, për të marrë kryqin duhet të futen në ujë të rinj meshkuj dhe ai që e merr i pari konsiderohet i bekuar dhe me mbarësi për këtë vit. Në lidhje me këtë festë ka lindur shumë kohë më parë, në disa vise të Italisë, edhe legjenda e Befanës. Që atëherë kjo festë, është bërë e rëndësishme dhe e shumëpritur. Kjo ditë filloi të kremtohej në Shqipëri vetëm pas viteve '90-të. Për shumë vite gjatë sistemit komunist ajo konsiderohej një festë e ndaluar.

- 16 Korriku Dita e Festës së Shën Naumit

Kjo ditë është një nga festat më të rëndësishme të besimtarëve ortodoks dhe të krishterë. Shën Naumi është një manastir shumë i hershëm i cili ndodhet në kufi me shtetin Maqedonas. Brënda në këtë manastir ndodhet njëkish e vogël në të cilën janë vendosur eshtrat e Shën Naumit I cili ishte një dishepull i shekullit të X dhe njëri prej etërve themelues të krishtërimit ortodoks. Afresket që ndodhen në këtë kishë janë kopje të origjinalit të shek XIX. Që prej vitit 1924 Shën Naumi ndodhet në administrimin e shtetit Maqedonas. Kjo ditë shënon flukse të mëdha vizitorësh shqiptar që pavarësisht padrejtesisë së bërë ata sërish nuk e harojnë këtë vënd të shenjtë dhe me histori. Me këtë tërësi festash të shumta gjithmonë turistët gjejnë arsye për të ardhur në Pogradec si dhe pse jo të jenë prezent në njërin prej tyre. Por pavarësisht këtyre përpjekjeve përsëri zhvillimi i turizmit dhe të ardhurat që ai sjell në këtë zonë janë të pakta, krahasuar me pasuritë që ai

zotëron.Fig .nr 3.2.1 Degët e turizmit të cilat mund të zhvillohen në të ardhmen në Pogradec.



Shumë degë të turizmit sot në Pogradec kanë potenciale por që nuk po zhvillohen,për të mos thënë që nuk po bëhen përpjekjet e duhura për zhvillimin e tyre.Turizmi i sporteve ujore nuk është ende i zhvilluar si degë e turizmit në këtë zonë megjithëse ka potenciale të mëdha me prezencen e liqenit të Ohrit.Në të mund të kryen sporte të ndryshme duke filluar që nga lundrimi me varkë, noti,peshkimi etj.Turizmi malor është ende një degë e pa zhvilluar në këtë zonë.Ky qytet në sezonin e dimrit ka reshje të shumta dëbore. Mali i thatë do të tërhiqte mjaft turistë nqs në të do të ndërtohej një qëndër skish.Sigurisht që kjo gje kërkon një investim të konsiderueshëm por njëkohësisht do të ishte dhe mjaft fitim prurës.Kjo gjë do të përbëntë vërtet dicka mjaft të vecantë sepse do të ishte e vetmja në këtë zonë.Në këtë mënyrë flukset turistike do të vinin edhe në sezonin e dimritTurizmi i biznesit dhe konferencave.Me një pozicjon gjeografik mjaft tëfavorshën në kufi me shtetin Maqedonas, Pogradecit mund të zhvillojë këtë degë të turizmit. Në dallim nga turizmi i dielli dhe plazhit kjo degëe turizmi në vetvete nuk është i promovueshmëm.Ai zhvillohet sipas mundësive të biznesit për të investuar në vënd.Pogradeci vitet e fundit po tërheq një numur të madh investitorësh dhe kjo përbën një nga elementët kyc për ta zhvilluar këtë degë.Por ashtu si dhe dhe fushat e tjera në ekonomi edhe kjo kërkon element të vecantë si prsh: krijimi i një aeroporti,dhënja e mjeteve me qera, orjentimin e shërbimeve taksi të rregullta dhe të sigurta.Turizmi fetar.Ashtu si në të gjith vëndin tonë edhe në qytetin e Pogradecit harmonia fetare është një vlerë mjaft e spikatur.Pogradeci ka kishën e vjetër ortodokse, që quhet kisha e Shën Mërisë dhe ndodhet në lagjen e vjetër të këtij qyteti si dhe një kishë të re me arkitekturë mjaft të vecantë të quajtur “Ringjallja”.Kjo kishëështë ndërtuar buzë liqenit në të njëjtin vënd ku u dogj kisha e vjetër gjatë fushatave antifetare më 1968.Ky qytet gjithashtu ka edhe dy xhami njëra ndodhet në qëndër të qytetit dhe tjetra në lagjen e quajtur Goricë.Xhamia në

qëndër të qytetit mori emrin Ebu Beqir Esidiku. Ajo është ndërtuar në vitin 1991 me mbështetjen e organizatës Ndimesa Islamike. Të gjitha këto degë mund të përbëjnë në të ardhmen psëjo edhe shtyllat e ekonomisë së këtij rajoni. Por kjo do të arihet vetëm n.q.s. do të ketë një bashkëpunim të mirë midis pushteit local, pushteit qëndrojr si dhe banorëve të këtij qyteti.

Me zhvillimin e të gjitha këtyre degëve të turizmit në një të ardhme numri i turistëve si dhe zhvillimi ekonomik në këtë zonë do të jetë në nivele vërtet të admirueshme jo vetëm nga qytetet brënda vëndit tonë por pse jo edhe për vëndet fqinje si Ohri dhe Struga që për fat të keq duhet pranuar që janë në nivele më të larat të zhvillimit ekonomik.

Tabela Të dhëna statistikore për numrin e turistëve në Pogradec

Viti	Nr I turistëve gjatë gjith vitit
2007	50.200
2008	60.130
2009	70.200
2010	100.000
2011	102.000
2012	150.000

Për fat të keq këto të gdhëna nuk janë të sakta pasi metoda e mbledhjes së tyre le për të dëshiruar. Dy janë metodat kryesore për mbledhjen e këtyre të dhënave : 1.Numurimi i hyrjeve në doganën kufitare të këtij vëndi ( dogana e fshatit Tushemisht) 2.Numurimi i bërë mbi bazë të qëndrimeve në hotele.


Të dyja këto metoda kanë mjaft anë negative duke filluar me metodën e pare, llogaritjet e bëra me këtë metodë nuk janë domosdoshërisht të sakta sepse kalimi ne një kufi doganor nuk do të thotë se të gjithë këtë kalimtar janë të destinuar për të bërë pushime në qytetin e Pogradecit, ata mund të shpërndahen në qytete të ndryshme në Shqipëri, dhe ana tjetër negative është së një individ mund të kalojë disa herë në muaj në këtë pikë kufitare dhe kjo numurohet sërish. Metoda e dyte gjithashtu ka mjaft anë negative sepse: 1. Jo të gjithë turistët mund të qëndrojnë në Pogradec ata mundt të jënë thjesht ekskursjonist dhe matja e këtyre të fundit nuk mund të bëhet me netëqëndrimi 2.Jo të gjitha hotelet dhe njësitë e tjera akomoduese mbajnë një rregjistër të

saktë të netë qëndrimeve të klientëve. 3Turistët të cilët akomodohen në shtëpi të cilat lëshohen me qera nuk figurojnë të regjistruar.Për të ndryshuar këtë situatë duhet që një grup i posacëm dhe i specjализuar në këtë fushë të kryejë një studim të mirfilltë. Kjo do të silltëjo vetëm shifra të sakta për turistët të cilët frekuentojnë këtë destinacion për pushimet e tyre por gjithashtu do të ndihmonte mjaft në hartimin e politikave të posacme për këtë zonë.

## Kapitulli VI Të dhëna të mbledhura nga pyetsori

Kjo temë është bazuar në tre pyetsore drejtuar tre elementëve kyç që e përbëjnë zhvillimin e turizmit në cdo vënd dhe ata janë: 1.Turistët 2.Subjektet turistike 3.Studentëve të profilit turizem.Zhgjodha të përdor pyetsorët sepse kanë një kosto të ulët si dhe informacioni i marrë munt të jëtë ishurmë .Pyetsorët janë të përbërë nga pyetje të hapuara dhe dhe të mbylluar.

Fig.nr.4.1 Pyetsori drejtuar turistëve, subjekteve turistike, studentëve të turizmit Pogradec.



Të tre këto element kanë një lidhje të ndërsjelltë me njëri tjetrin.Në krye të kësaj piramide qëndon turisti më pas vijnë subjektet turistike dhe studentën e turizmit të cilët në një të ardhme duhet ti shërbejnë turistik, dhe nga ana tjetër turistik shpërblen përkushtimin e dy elementëve të tjerë duke riardhur sërisht kjo do të sjell sigurisht shpenzime më të mëdha dhe për pasoj fitime më të mëdha për dy palët e tjera.Turisti përbën një faktor të jashtëm sepse ai vjen nga një vënd tjetër ndërsa dy elementët e tjerë janë të brëndshëm.

4.1Pyetsori drejtuar turistëve.Ky pyetsor është plotësuar nga 50 turistë vëndas dhe të huaj të cilët kanë preferuar Pogradecin si destinacion turistik.Turistët janë të moshës 25 deri 45

vjec.Zhgjodha këtë grupmosh sepse mendoj se ata kanë një nivel ekonomik me të mirë së moshat e tjera si dhe sepse janë më të gacëm për të udhëtuar.

Pyetsori drejtuar turistëve përbëhej nga 13 pyetje

Pyetja e parë ishte : 1.Sa rëndësi i kushtoni pushimeve turistike? Dhe rezultatet e marra janë këto:

Tabela nr .4.1.1 Pushimet dhe rëndësia që i kushtojnë turistët.

Rëndësia	Pak	Mesatarisht	Shumë
Numri.	4	15	31

Nga këto të dhëna dali se numri më i madh ipushuesve i kushtojnë një vëmëndjëtë nivelit mesatara dhe shume, kryerjes se pushimeve.Nga kjo del se turistët janë në një nivel të lartë planifikimi për kryerjen e pushimeve të tyre.Pyetja e dytë e pyetsorit ishte :Pse preferoni të bëni pushime në qytetin e Pogradecit?

Tabela nr.4.1.2 Elementët të tërheqës turistik.

Elementët të tërheqës	Nr.i turistëve që e preferojnë
1.Klima (ajri i pastër dhe qetësia)	25
2.Gastronomia	10
3.Liqeni I Ohrit	10
4.Monumentete kulurore dhe historike	5

Vërehet qartë se klima është një nga tërheqjet kryesore për turistët në qytetin e Pogradecit dhe mëpas vijnë elementët gastronomik si dhe Liqeni i Ohrit të cilat kanë të njëjtata preference , kjo vje edhe sepse intervistata janë kryer ngjate perjudhës teteor dhjetor , por ajo e cila më befasoi më shum ishte se monumetete kulurore dhe historike për shum pak turistë përbënin një tërheqje.Nga kjo del se në këtë destinacion ende nuk janë formuar bazat e një turizmi i cili është i

Nga tw dhenat vwrehet se 22% e pushuesve prefesojnw pranverwn nw pjesa mw e madhe e tyr rreth 56 % verwn,8% vjeshtwn dhe 14% dimrin.


Kjo tregon njw tjetwr element te njw turizmi tw pa qwndrueshwm pasi ai tejmbushte nw verw por, wshtw i boshatisur thujse nw stinwtw e tjera.

Ky zhvillim sezonal ka mjaft anw negative si: kosto sociale tw lata, tej shfrytwzimi i burimeve natyrore kulurore, krahu i punws i pa qwndrueshwm.

Pwr tw ndryshuar kwtw situatw duhen pwrpjekje mw tw mwdha duke filluar qw nga promovimi.

bazuar te kutura dhe njohja e saj.  
perudha në të cilen ju bëni pushime?  
bërjes së pushimeve

Pyetja e trete :Kur është  
Fig.nr.4.1.1 Perjudha e



Pyetja e katërt është :Si i vlerësoni investimet e bizneseve në fushën e turizmit në Pogradec?

Tabela .nr 4.1.3 Vlerësimet e investimeve në bizneset turistike.

Vleresimet	Të dobta	Të mira	Shum të mira
Numri I turistëve	6	29	15

Të dhënat tregojnë se më shumë se 90 % e turistëve janë të kënaqur nga investimet e bëra në fushën e biznesit në turizëm, dhe këtu përfshihen restorantet dhe hotelet. Gjithashtu dhe pyetjes për cilësinë e shërbimit turistët ju përgjithësisht në këtë mënyrë ata kishin të drejt të vlerësonin më pak nga 5 qështë vlerësimi maksimal deri në 1 pikë qështë vlerësimi minimal. Më shumë se 75 % e turistëve e vlerësuan shërbimin me pikët maksimale, 19 % e vlerësuan shërbimin me pikë mesatare dhe vetëm 6% e vlerësuan atë me pikët minimale. Një pyetje tjetër me rëndësi ishte se çfarë turizmi preferoni të bëni në Pogradec ku turistët kishin tre alternative zhgjedhjesh. Nga 50 të pyetur 30 prej tyre preferojnë turizmin liqenor, 8 preferonin turizmin kulturor ku 6 prej tyre janë të huaj dhe 2 shqiptar, 12 të tjerë duan një ndërthurje midis turizmit liqenor dhe atij kulturor. Turistët u pyetën se si e merrnin informacionin për egzistencën e këtij destinacioni turistik dhe përgjithësisht janë:

Tabela 4.1.4 Mënyra e marrjes së informacionit.

Mënyra e marjes së informacionit	Numri I turistëve
Në medjan e shtypur dhe të folur	10
Ne internet	26
Me anë të inpresjoneve të miqve	12
Broshurave , guidave	2

Dominues është internet si një mjet për tu informuar për këtë destinacion turistik, më pas vjen informimi nga ana e miqve më anë të inpresjoneve të tyre, në vënt të tretë qëndon medja e cila tërheq vëmëndjen e turistëve me anë të emisjoneve dhe artikujve të ndryshme që i kushtohen këtij destinacioni dhe elementi i cili duhet të ishte primar qëndron në fund të listës vetëm 2 nga 50 turistë informohen me anë të guidave apo broshurave të ndryshme kjo tregon se kësaj mënyre promovimi i është kushtuar shumë pak vëmëndje. Përsa i përket forms së organizimit për të bërë pushime në këtë vënd përgjigjet janë: Më shumë se 87 % preferojnë mënyrën familjare të organizimit dhe pjesa tjetër vënë në grup. Frekuenitimi i këtij destinacioni nga turistët ishte : 70 % e tyre ishin të rikthyer në këtë destinacion dhe vetëm 30 % prej tyre e vizitonin për herë të parë këtë vënd.

Një faktor pozitiv është që përçinja më e tartë e turistëve rivijnë në këtë vënd kjo do të thotë që ata janë të kënaqur nga ajo se çfarë ofron ky vënd. Mënyra më e preferuar e turistëve për tu akomoduar ishin shtëpitë private të cilat lëshohen me qera dhe këto kryesisht në fashatin Tushemisht ( me afro 30 prej tyre) kjo për shkak edhe të cmimit më të ulët që ato kanë krahasuar me hotelet të cilat preferoheshin më pak ( 20 turistë )

Pyetja e radhës ishte : Si ju duken cmimet për të bërë turizëm në këtë qytet?

Tabela.nr 4.1.4 Niveli i cmimeve për të bërë turizëm në Pogradec

Niveli I cmimeve	N.i ulët	N. I arsyeshëm	N.i lartë
Nr.i turistëve	15	30	5

Një numur total prej 45 turistësh kësaj pyetjeje i është përgjigjur se cmimet janë të ulta ose të arsyeshme cka do të thotë se për ta se të bërit turizëm në këtë vënd është thujse i përballueshëm dhe vetëm 5 turistë mendonin se cmimet në përgjithësi në këtë destinacion janë të larta dhe të pa përballueshme. Por ky nivel i ulët i cmimeve është ndoshta edhe një nga arsytet për të tërhequr sa më shumë flukse turistike.

Tabela.nr 4.1.5 Turistët në këtë destinacion do të donin tëndryshonin :

Ndryshimet që duhet të bëhet.	Nr.i turistëve
Infrastrukturën rrugore në hyrje të qytetei.	23
Vendosja e sinjalistikës. drejtuese dhe orjentuese	11
Mungesen e shërbimeve me orare të zhgjatura sidomos në sezonin dimëror.	16

Problematika kryesore e turistëve sigurishte qëështë infrastruktura e cila është mjaft e dobët në hyrje të qytetit, më pas shqetësimi tjetër është mungesa e sinjalistikës orjentuese dhe drejtuese për në vendet të tilla si : Driloni, Tushemishti, etj.Mungesa e shërbimeve me orare të zhghatura përbën një tjetër problem dhe këto shërbime përfshin pub restorante farmaci me shërbime 24 ore nëditë .Perfundimete e nxjera nga ky pyetsor i cili ju drejtua turistëve ishte:

1.Turistët të cilët vijnë në Pogradec i kushtojnë një vëmëndje të vecantë pushimeve të tyre në këtë vënd si dhe shpenzimet që do të kryejnë nëtë .2.Klima është arsyeja dominuese në tërheqjen e turistëve në këtë vënd.

3. Perjudha në të cilën ky vënd është më së shumti i populluar është vera.4.Përsa i përket investimeve në turizëm, cmimeve si dhe shërbimit të ofruar prej njërive akomoduese vlerësimi në vija të përgjithshme ishte pozitiv.5.Forma më e preferuar e turistëve për të bërë pushime në këtë destinacion është organizimi familjar.

6.Problematika kryesore e cila kërkon një investim të mënjëhershëm është infrastruktura rrugore.Të gjitha elementët e tjerë përvec cmimit përbëjnë anë negative duke marrë parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm i cili thelbin e zhvillimit të turizmit e vet e kultura tradita por kur ky lloj turizmi është shumë pak I zhvilluar në këtë vën atëhere nuk mund të presim shumë prej një turizmi sezonal.Në këtë kuadër është e nevojshme një ndërgjegjësim i popullatës për rëndësinë dhe vlerat që mbart kjo degë e turizmit. 4.2 Pyetsori drejtua subjekteve turistike.

Pyetsori drejtuar subjekteve turistike fillon me pyetje se kur ata e kanë nisur këtë veprimtari nga 35 subjekte turistike vetëm 1 prej tyre e kishite filluar veprimtarin që në kohë shumë të hershme nga viti 1970 dhe ky është Hotel Enkelana ose i quajtur ndryshe Turizmi.Vetëm 10 prej tyre kishin filluar në harkun kohor 1998 deri në 2004 ndërsa pjesa tjetër që janë 24 subjekte ishin ndërtaur



nga viti 2005 deri në vitin 2011 cka tregon që kjo perjudhë ka qënë më e lulezuara përse i përket investimit në subjektete turistike

Pyetjes se saështë numri mesatar i netë qëndrimeve në këtëo sukjete turistike rezultatet janë si mëposhtë:

Tabela

nr.4.2.1 Netë qëndrimet në subjektet turistike.

Netë qëndrime ( për një muaj)	Turistë të huaj	Turist shqipëtar
Nga 1-3	340	12000
3-6	100	15900
6-15	65	350
Më shum se 15 netë	14	170
Totali	519	25.570

Numri total i netë qëndrimeve në hotelete në këtë qytete janë 26.089, ku 519 janë turistë të haj dhe 25.570 janë turistë vëndas.Vërehet se numri më i madh i netë qëndrimeve është nga 3 deri në 6 ditë kjo sigurisht për turistët vëndas ndërsa për ata të huaj netë qëndrimet më të larat shënohen në harkun kohor nga 1 deri në 3 nëtë. Numri më i ulët inetëqëndrimeve shënohet në harkun kohor për më shumë se 15 ditë që për të huajt është 14 ndërsa mesataraja për turistët shqiptarë është 170.Me këto rezultatae del se Pogradeci është një destinacion turistik kalimtar nga një vënd në tjetri dhe jo primar. Numrin më të madht të turistëve të huaja e përbëjnë maqedonasit kjo edhe për vetë faktin e afërsisë gjeografike të vëndeve, më pas vijnë turistët gjermanë të cilët qëndrojnë në vëndin e dytë dhe më pas vijnë anglezët,grekët etj.

Cmimet për një natëqëndrimi në këto hotele varjojë si më poshtë: Për dhoma të cilat kanë pamje nga liqeni cmimi i tyre varjon nga 3.000 lek deri në 5.000, dërsa për dhomat e tjera ato varjojnë nga 1.500 lek deri në 3.000 lek. Nga kjo del se cmimi mesatar i një natë qëndrimi në këtë qytet eshte 3.000 lek ku përfshihet edhe mëngjesi.

Pyetja tjetër drejtuar pronarëve të subjekteve turistike ishte :Cila është perjudha më epreferuar e turistëve për të qëndruar në këtë destinacion dhe pse? Mëshumë se 80 % e pyre u përgjigjën që sezoni më i preferuar për të bërë pushime është vera ndoshta edhe sepse atëhere njerzit janë më të lirë për të udhëtuar ( marja e pushimeve verore).Shum prej tyre thotë se

prenotimet fillojnë afro 2 javëmë parë pasi fluksi është shumë i madh dhe shumë prej turistëve rrezikojnë të mbetjet të pa akomoduar. Perjudha kulmore e zënjes së këtyre hoteleve është korriku dhe deri nga mesi i gushtit. (një perjudhë shumë e shkurtër kohore për një dyndje kaq të madhe). Përsa i përket mënyrës së promovimit ata përdori këto metoda si më poshtë:

Tabela 4.2.2 Mënyrat e promovimit.

Mënyra e promovimit	Nr. i subjekteve
1. Më anë të internetit	25
2. Me anë të broshurave	7
3. Me anë të publicitetit në radio dhe tv	3

Pjesa më e

madhe e këtyre subjekteve përdorin internetin si një mënyrë promovimi mjaft efektive dhe pa kosto afro 25 subjekte zotërojnë një faqe ëeb të cilën e administrojnë. Vetëm 7 prej subjekteve përdorin broshurat e ndryshme informuese pasi ato janë me një kosto relativisht të lartë për të prodhuar dhe vetëm 3 nga 35 subjektet turistike përdorin si mënyrë promovuese publicitetin në radio apo televizionet lokale kjo për arsyen se edhe kjo mënyrë promovimi është me një kosto relativisht të lartë.

A është e lehtë të ushtrosh

veprimtari në fushën e turizmit? Dhe nëse jo ku qëndron vështirësia? Kësaj pyetje të intervistuarit i janë përgjigjur kështu: Pothuajse 92% tregojnë se të ushtrosh veprimtari në fushën e turizmit është e vështirë sepse:

1. Duhet një koordinim mjaft i mirë i të gjithë elementëve duke filluar që nga stafi ambjenti etj 2. Kostot e investimit fillestar janë mjaft të larta 3. Turizmi tashmë është kthyer në një veprimtari jo të qëndrueshme dhe kjo varë nga gjendja ekonomike situatë politike etj. Bashkëpunimi midis subjekteve turistike dhe

istitucioneve përkatëse të kësaj fushe është mjaft të dobëta. Më shumë se 20 pronarë të subjekteve turistike as që e dinin që në bashkinë e qytetit egzistonte zyra e turizmit. Kjo përbën një hapsirë mjaft të madhe mangësie jo vetëm nga ana e pronarëve të këtyre subjekteve por edhe nga vetë Bashkia e këtij qyteti e cila nuk bën mbledhje dhe diskutime të kësaj fushe.

Pyetja e fundit e pyetsorit drejtuar pronarëve të subjekteve turistike hotele motele etj ishte Cfarë mendoni se mund të bëjë shteti për të përmirësuar turizmin?

Tabela

.nr.4.2.3 Shteti dhe ndikimi i tij.

Përgjigjet	Nr.i subjekteve
1.Të krijojë lehtësira në marjen e huave të ndryshme me norma interesi të ulta	21
2.Të kryej investime në rrugët nacionale	9
3. Të promovojë Pogradeci si destinacion turistik .	5

Përfundimi është i qartë subjektete turistike kërkojnë të marin hua nga bankat me një normë interesi të ulët dhe më njëafat shlyerje të gjatë, kjo mendojnë 21 te intervistuar se është primarja për të përmirësuar turizmin në këtë zonë ,9 prej tyre mendojnë si primare është investimin në rrugët nacionale që të shpien në Pogradec dhe 5 prej tyre mendojnë se shteti duhet të përfshijë Pogradecin në spotete publicitare kombëtare dhe ndërkombëtare .

Në përfundim të këtij pyetsori dalin në pah një sërë problematikash ku më të rëndësishmet janë :1.Netë qëndrime në një nivel te ulët në hotele nga 1 deri në 3 netë.

2.Dyndje e madhe turistësh në sezonin veror cka e bën më të vështirë menaxhimin e situatës.

3.Vështirësitë e shumta në ushtrimin e aktivitetit turistik si pasoj e një vëmëndje të ulët të pushtetit qëndror dhe lokal përkundrejt kësaj dege të ekonomisë.

4.Kostoja e lartë e ushtrimit të veprimtarisë në këtë fushë.

4.3 Pyetsori drejtuar studentëve të profilit turizëm në qytetin e Pogradecit.

Pyetsori drejtuar studentëve të Universitetit “F.Noli” profile turizëm përbëhet nga 9 pyetje. Ky pyetsor është plotësuar nga 30 studentë të vitit të dytë të kësaj dege.Pjesa më e madhe afro 98% e studentëve ky universitet ishte i pari që ata ndiqnin.dhe vetëm 2% e kishin këtë universitete të dytë të ndjekur.Pyetjes se përse këta student zhgjedhën këtë degë për të studjuar ata u përgjigjen: 20 nga 30 studentë e zgjedhën këtë degë sepse mendojnë se ajo në një të ardhme do të jetë dega kryesore e zhvillimit të ekonomisë në qytetin e Pogradecit , 5 mendojnë se kjo degë do tu sjelli atyre një punë më të mirë në të ardhmen ,3 prej tyre mendojnë se tregu ka nevojë për më shumë njerëz tëspecjalizuar në këtë fushë dhe 2 fituan vetëm këtë degë dhe nuk kishin mundësi tjetër. Nga këto rezultatate del se më shumë se 89 % mendojnë se dega që ata kanë zhgjedhur për të studjuar ka një të ardhme të sigurt në vëndin në të cilin ata jetojnë , kjo do të thotë se përpjekjet e tyre do të jenë të mira për të ndryshuar sitatën aktuale, e cila për hirë të së vërtetës nuk është aq e

zhvilluar sa duhet krahasuar me burimet qe ajo disponon.

Pyetjes se a

zotëronin këta student ndonjë subjekt turistik ata u janë përgjigjur: 7 prej tyre zotëronin një subjekt turistik ( hotel, restorant etj) dhe pjesa tjetër (23 studentë ) nuk zotërontë asnjë subjekt të tillë. Pronarët e subjekteve turistike po bëjnë përpjekjet e para për të njohur rregullat dhe menytrat e funksjonimit të turizmit , kjo do të sjellë në një të ardhme investime më të mirë organizuara si dhe drejtim të shërbimeve të specializuara në këtë fushë.


Amendoni se zhvillimi i turizmit në qytetin e Pogradecit është në nivele më të larta të muncme dhe nqs jo pse? Rezultatet e mara nga kjo pyetje janë :

Tabela.nr.4.3.1 Zhvillimi i turizmit dhe niveli izhvillimit.

Niveli I zhvillimit të turizmit	Nr.i studentëve të përgjigjur
Ne nivele të larta	2
Në nivele mesatare	23
Në nivele të ulta	5

Nga të dhënat del se shumica e studentëve pra 25 prej tyre mendojnë se turizmi në qytetin e Pogradecit nuk është i zhvilluar në nivel të lartë.Kjo tregon se për të aritur këtë nivel ka një sërë problemesh të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme sic janë:

Figura.nr.4.3.1 Problemet e hasen sot në zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm në Pogradec.



Problematikat kryesore që sjellin një zhvillim të niveleve jo të larta në këtë qytet janë mungesa e promovimit si dhe infrastruktura e dobët të cilat përbëjnë 80 % e përgjigjeve ndërsa organizimi i dobët dhe sezonaliteti përbejnë 20 % të problematikave .

Studentëve ju bë pyetja se ku mendonin ata se do të punësoheshim me mbarimin e shkollës dhe përgjigjet e tyre janë si më poshtë:

Tabela.nr

#### 4.3.2 Punesimi i studentëve.

Ku mendoni se do të punoni	Nr.i studentëve të përgjigjur
Në komunë ose bashki në sektorin e turizmit	8
Në agjensi turistike	14
Menaxher të një subjekti turistik	8

Profesjoni më i deshiruar prej studentëve është të punuarit në agjensit turistike më pas vjen punësimi në komunë ose bashki në sektorin e turizmit dhe më pas manxhimi i subjekteve turistike në këtë zonë.

Hapat e para në mirë organizimin e turizmit po bëhen se sa ato do të realizohen kjo mbetet për tu studjuar në një të ardhme. Pyetja e fundit e vendosur në pyetsorin drejtuar studentëve ishte se si mendonin ata zhvillimi i turizmit sjell vetëm anë positive apo negative dhe cilat janë ato?

Rezultatet e marra janë si më poshte:

88 % e tëpyeturve mendojnë së zhvillimi i turizmit sjell vetëm anë positive të tilla si :

1.Zhvillimi i ekonomisë 2. Ritja e numrit të të punësuarve në këtë sektor 3. Ritja e tëardhurave .22 % e studentëve mendojnë së zhvillimi i turizmit përvec anëve positive sjell dhe mjaft anë negative.Ku ndër më të spikatuarat janë:

1.Shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore gjatë pikut të zhvillimit 2.Zhurmat e shumta të krijuara nga flukset turistike 3.Ndotja e ambientit nga turistët .

Përfundimet e nxjera nga pyetsori drejtuar studentëve të profilit turizëm në Pogradec janë:

1.Studentët të cilët sudojnë në turisëm përbëjnë element mjaft pozitiv që do të sjellin zhvillimin e turizmit në këtë qytete bazuar në burime njerëzore të kualifikuara.2.Evidentimi i problemeve nga ana e tyre kërkojnë një investim të konsiderueshëm për tu kthyer në prioritetete.

3.Për fat të keq asnjëri prej studentëve deri në kohën në të cilën u krye pyetsori nuk kishte kryer as edhe një ditëtë vetme praktik në këtë fushë.

4.Mbështetja nga

ana e bashkisë si dhe nga subjektete turistike për këtë student duhet të jetë më e madhe duke i lejuar ata që të paktën një herë në vit të ushtrojnë dijet e mara në formën e praktikës pranë tyre në fushën të cilën ata po studjonë. N.q.s këto do të realizohen atëhere këta student do të japin kontributin e tyre maksimal në zhvillimin e turizmit në një të ardhje jo shumë të largët në qytetin e tyre.

Përfundime të përgjithshme të nxhjera nga te tre pyetsorët. Produkti turistik që Pogradeci ofron është mjaft kompleks në vetvete ai përbëhet nga një sërë të mirash materjale dhe jo materjale. Ky produkt turistik aktualisht bën pjesë në fazën e dytë të ciklit të produktit turistik në modelin e Butlerit në fazën e përfshirjes sepse ai karakterizohet nga këto tipare: 1. Ka një rritje të numrit të vizitorëve nga viti në vit, gjithashtu në shërbim të tyre janë vënë një sërë subjektesh turistike duke filluar që nga dyqanet e suvenireve , rritja e numrit të hoteleve ,restoranteve etj. 2. Pjesa më e madhe e popullatës përshtain sjelljen e tyre duke qënë mikpritës për të pritur turistët si dhe kuptojnë se zhvillimi i turizmit sjell përfitime të mëdha për ta. 3. Mënyrat e promovimit po fillojnë që të jenë në nivele më të larta se 5 vjet më parë . 4. Janë kryer një sërë investimesh në kuadër të zhvillimit të turizmit por që ende ato nuk janë të plotësuara në nivelët optimale.

Në përfundim të kësaj teme del se ende në këtë qytete nuk janë plotësuar të gjitha elementët e muncëm për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu zhvillimi i turizmit të deri tanishëm është drejtuar më së shumti në një perjudhë të caktuar për afro 3 mujore, për ta bërë turizmin të qëndrueshëm në këtë vënd duhen hartuar politika dhe strategji mbështetëse.

Për të regulluar këtë situatë duhet patur parasysh një sërë rekomandimesh un po përmënd më posht vetëm shumë pak prej tyre ato që më duken më kryesore.

.E ardhmja e turizmit në këtë vënd duhet me pa tjetër që të jetë zhvillimi i turizmit kulturor sepse ai është i shtrirë përgjat gjith vitit pra monumentete kuturore mund të shihen vizitohen në cdo perjudh të vitit ndryshe nga turizmi blu i cili është mjaft i kufizuar .

Duke u fokusua në turizmin kulturor gastronomikartisanal ky qytete do të ketë një ekonomi më të zhvilluar si dhe shfrytëzim të burimeve turistike më të balancuar.

## Rekomandime

1. Duhet bërë promovimi i trashigimisë kulturore dhe ekoturizmit si bazë për mundësi të reja zhvillimi të një turizmi të qëndrueshëm.
2. Ruajtja më e mirë e mjediseve dhe vëndeve me trashigimi kulturore.
3. Krijimi i një reviste turistike vjetore e cila të shpalsë të gjitha ngjarjet dhe evenimetet që organizohen në këtë qytet.
4. Kryerja e investimeve rrugore në vëndet turistike historike është i domosdoshëm.
5. Krijimi i agjensive turistike dhe paketave turistike të cilat kanë si destinacion Pogradecin.
6. Inkurajimi i qeverisjeve vendore dhe lokale për restaurimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve historike dhe kulturore për një tërheqje kulturore më të madhe .
7. Të forcohet roli i Ministrisë së Mjedisit në bashkëpunim me shërbimin pyjor për mbrojtjen e florës dhe faunës, së zonës së Pogradecit.
8. Dizajnimi dhe publikimi i një kalendari vjetor me ngjarjet më të rëndësishme të zonës ( me karakter fetar, historic dhe kulturor ) ,do të përbënte një formë të mirë promovimi.
9. Koperimi dhe bashkëpunimi me agjensitë turistike shqipëtare dhe agjensitë e udhëtimeve, për promovimin e vlerave turistike të zonës dhe përfshirjen e tyre në paketa promovuese të paketave të tyre turistike.

10. Ndërgjegjësimi i komuniteteit për vlerat turistike potencjale egzistuese, në këtë vënd.
11. Nxitja e turizmit familjar dhe agroturizmit.
12. Inkurajimi i sektorit privat për të investuar dhe mundësuar ngritjen e një hoteli të madh për grupet e mëdha.
13. Inkurajimi i sektorit privat për kualifikimin e stafit manaxherjal.
14. Duhet bërë investime të vazhdueshme sidomor në rrugët hyrëse të qytetit , dhe një mirëmenaxhim i tyre.
15. Duhet krijuar shoqëria e turizmit në këtë qytet në të cilin të marrin pjesë specialistët e fushës.
16. Pushteti qëndror duhet të përfshijë këtë destinacion në spotete publicitare në promovimin e turizmit në Shqipëri.
17. Krijimi i një stafi të posacëm i cili të merret me llogaritjet e të dhënave statistikore të turistëve , që hyjnë dhe dalin nga ky qytet.
18. Duhet hartuar dhe zbatuar një projekt i cili të informojë dhe drejtojë grupet turistike në qendrat natyrore dhe kulturore.
19. Duhet nxitur sektori privat për të zgjeruar veprimtarinë e dyqaneve egzistuese dhe për të hapur dyqane të reja me punime artizanale , ushqime dhe pije tradicionale të cilësisë së lartë.
20. Ulja e sezonalitetit me anë të formave të ndryshme të promovimit si ulja e cmimeve gjatë sezonit dimëror .



## Përfundime

Të ardhurat nga turizmi në qytetin e Pogradecit mbeten ende në nivele të ulta krahasuar me qytetet e tjera turistike si Durrësi, Vlora apo edhe Saranda e.j. Kjo nënkupton që turizmi në këtë destinacion nuk është i qëndrueshëm. Produkti turistik i ofruar në Pogradec mendoj se ndodhet ende në fazën e përfshirjes mbetet ende shumë punë për tu bërë, gjithnjë e me shumë po vërehet një mangësi midis pushteti lokal dhe qendror duke ja hedhur përgjegjesin e bërjes së punëve tek njëri tjetri. Burimet turistike të shumta që disponon ky qytet janë të mëdha nëq këto burime do të dinë se si ti shfrytëzojmë atëherë benefitet që ne do të marrim do të jenë të mëdha, kjo duke filluar që tek punësimi i individëve të specializuar të fushës, duke vazhduar me zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm nga të gjitha nivelet e planifikimit, vendimarrjes, menaxhimit, si në nivel publik qendror dhe lokal, ashtu dhe në sektorin privat. Ligji për turizmin është dokumentakjoni më i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në vënd. Ai nga ana tjetër përbën një hendek të madh pasi në të duhet përveç të tjerash të trajtohet edhe gjëndja ekonomike e vëndit si dhe mundësit reale për ti zbatuar akteta nën ligjore të cilat e përbëjnë atë. Ende ky ligj nuk po zbatohet nën për nën nga vëndi ynë. Gjithashtu ai duhet të jetë më fleksibër dhe të përshtatet me planeve strategjike lokale. Rritja e financimeve: në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aseteve natyrore e kulturore përmirësimin e sistemeve të menaxhimit për zonat me interes kulturor dhe natyror, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e imazhi. Përmirësimi i standarteve të shërbimit, pra cilësia e fuqisë punëtore në industrinë turistike, si dhe duke ofruar në mënyre të vazhdueshme produktet e duhura të vlerës dhe cilësisë së kërkuar për të plotësuar kërkesat e grupeve të synuara. Vetë ligji për turizmin nr.9734 duke u bazuar në nenin 5 të tij thuhet Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me trashigiminë kulturore kombëtare, traditat dhe zakonet e popullit shqipëtar, si dhe

në parimin e mbrojtjes dhe përdorimit të njëjtë të burimeve turistike. Por zbatimi i këtij ligji është ende shumë larg realitetit. Eardhja e turizmit në këtë qytet duhet të fokusohet më së shumti në zhvillimin e turizmit kulturor duke qënë së burime për ta zhvilluar atë janë të shumta .Për këtë në radh të parë duhet një promovim më i fortë dhe në radh të dytë duhet një bashkëpunim midis qeverisjes lokale si dhe qeverisjes vendore. Vetëm në këtë mënyrë turizmi mund të shndërohet në një degë të qëndrueshme e ekonomisë. Duke mos krijuar sezonalitet por ai do të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit.



## Bibliografia

Doka.DH Draci.B“Gjeografia e turizmit” Shblu, Tiranë 2009

Dervishej L, Gërxfhani K, “ Turizmi Shqipëtar dhe edukimi profesional” Gazeta Korrieri data 29.10.2003

[www.bashkiapogradec.gov.al](http://www.bashkiapogradec.gov.al)

Prof.Dr. Vjollca Bakiu “ Manaxhimi I turizmit” Botimet Erik Tiranë

Vita Koja “ Aspekte të organizimit dhe të drejtimit të rajoneve turistike pritëse” Botimet albPAPER 2002.

Tomorr M. Starova “Pogradeci vështrimi etnografik, ekonomik,folkloric” Botimet Drita 2000.

Prof.As.Dr. Vita Koja, Dr.Klodjana Gorica “Marketingu I turizmit”

“Pogradeci celës turistik” Botimet Celsi 2011

Kristaq Manushi “Vendlindja ime Pogradeci” botimet Erik Tiranë 2008

Mitrush Kuteli“Në një copë të Ilirisë së poshtme” Ribotim Toena 1999.

Perikli Qiriazhi “ Monumentete e natyrës e të kulturës të rajoni të Pogradecit dhe Prespës” Tiranë Genti-Grafik 2000.